

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E DHJETË

X

Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së

Oslo, 2010

HYRJE

Shkruan Dr. Ibrahim Betavi , ish profesor ne universitetin e El-Ez-herit, i dalluar me sjelljen e tij dhe personalitetin e tij.

Vëllai im, Shejh Shaeraviju u konsiderohet dashuri prej dukurive shpirtërore me kohen ku është prezent dhe mbizotëron materializim. Rruga e tij dhe pasqyrimi I tij I tematikave bashkëkohore, ne forme dhe mënyrë tashme te njohur dhe ky është shkaku se atë e dëgjojnë miliona dëgjues nga te gjitha kategoritë shoqërore, dhe nivelet e tyre intelektuale. Dobia e tij zgjerohet aq sa pranojnë dhe zemrat e zbrazura, dhe aq sa shkëlqen ne kohen kur dominojnë errësirat materialiste dhe nivelet e larta net e gjitha poret e jetës sa qe ku depërton edhe ta ato te cilët dine për fe e qe një pjesë te tyre ka prek edhe shejtani duhet përfituar prej kamatës, për te cilët zoti I Lartmadhëruar ka thënë: Atë te cilët përfitojnë dhe ushqehen prej kamatës, nuk ngriten ndryshe ne ditën e kijametit përpos ashtu siq ngritet atë qe e kaplon shejtani. Kjo nga arsyeja se atë kanë thënë: Nuk ka dyshim se edhe shit-blerja është e ngjashme me kijametin. Ky është shkaku se te rinjtë jan me te shpejte se te vjetrit ne perkrahjen e ideve te shaeravijut. Sepse te ai gjindet sinqeriteti I cili mungon te shumica e tjereve ashtu siq ngjitet ushqimi shpirtëror, tek I urituri te cilit I ka munguar ushqimi për një kohe te gjate. Ketu eshte edhe arsyeja e rrahjeve te tematikave te shume numërua qe te mbuloje zbrastine shpirtërore tek te rinjet duke fillu prej tematikes se „Kadase” dhe „Kaderit” e deri te fesjesa, te perzierit e femrave meshkuj ne kufij te cilat lejon ligji I sheratit si kunderpergjigjje ndaj mendimeve te thirresve islam te humbur, te çilet thonë se duhet shiqu vetem kuranin e nuk dine se suneti eshte plotesues edhe sqarues I tij, sqarues I perpikte e jo sipas deshires apo epsheve e duke sqaruar çështjen e shejtaneve ifrit, gjurmët dhe pasojat e magjive te cilet ndikojne ne ndarjen mes bashkëshortëve e deri te teoria e krijimit te njeriut dhe zhvillimit te tij duke deklaruar „ cilët jan, dhe ku jan faktorët qe ndikuan qe majmuni njeri !?: Pse llojet tjer te majmuneve kanë mbetur ne majmunërinë e tyre. Pse ato nuk jan shndërruar ne njeri !?

Kështu ky njeri I ndërlidhë çështjet bashkëkohore me bazat themelore islame dhe ndriqon rrugën e kalimtarëve djem e vajza qofshin ato te rinjtë e pleq. Duke kaluar prej lules në lule, prej kopshtit e në kopsht, për të zgjedh enigmat bashkëkohore.

Ky është shkaku se ne kemi thane shejh-shaeraviju është edukim shpirtëror I këtij shekulli, shekulli I cili mundohet që njeriun ta bëjë rob të mitorjes larg nga ligjet e Allahut.

PERPILIMI I FETFAVE

Kur ky njeri flet, flet zëshëm, me oratori me ide të shkëlqyeshme dhe domethënëse, të cilat depërtojnë në mendje e zemër në të njëjtën kohë. Mirëpo ti nëse I përqendron këto dy elemente para librit të ndihmon ti kesh gjithmonë pranë nëse nuk I ke regjistruar. Kjo është rëndësia e nxerrjes së teksteve dhe renditja e tyre të cilat janë të shumënumërta nga një ligjërues duke e përcjellë atë vazhdimisht në vende të ndryshme për të prezantuar idetë e ligjëruesit me precizitet, ashtu edhe ligjëruesi me I dhanë besim të plotë për përpilimin e atyre ideve. Mirëpo vështirë e ka përpiluesi me shut diçka të re , ose me zbuluar diçka të re për shkak se ai tenton me treguar atë që e ka thënë ligjëruesi duke mos I dhënë përparësi asaj çka e shkruan vetë se përndryshe nuk do të dëgjohej.(lexohej)

Nga kjo rezulton vepra e letrarit Dr. Sejid Xhemilë doktor dhe po ashtu mjek i respektuar duke përpiluar idetë e të nderuarit dhe të respektuarit shejh sheravijut të cilat I ka përpiluar prej ligjëratave dhe fetvave në fushën e njohurive të fikhut, njohurive shoqërore për t'ia lehtësuar studentëve dhe lexuesve për të arritur deri te qëllimi I tyre. Kjo është shkëndija prej shkëndijave të dritës të cilën mund ta çmojmë dhe ta vlerësojmë mire. Kështu edhe përpiluesi besnik ka shpërblim për angazhimin dhe mundin e madh për rininë e kësaj kohe për qetësimin e zemrave të tyre, për forcimin e besimit të tyre dhe për forcimin e rrugës së tyre të drejtë.

Më kanë mbetur edhe dy fjalë:

E para : Përpiluesi I këtij libri e demanton mendimin e Akadit I cili mendim përputhet me orientalistët se : Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë gjenial sikur xhenialet tjerë përderisa mrekullia mbinatyrore bie ndesh me gjenialitetin e tjerëve. Kjo është e vërtet dhe e drejtë të cilën Shejh Shaeraviju I ka treguar fuqishëm për të mos ngelin lexuesit e prof Akadit në rrjetin e tij. Zoti I Lartmadhëruar qoftë I hidhëruar mbi ata të cilët ia kanë zili vulës së pejgamberëve dhe më të madhin e gjithë njerëzimit.

E dyta: Të ngatërruarit e fjalës terminologjike e cila përdoret me përkthim, e cila I jep kuptim krejt tjetër siq është fjala „ILMANIJE”-sekularizëm e cila përkthehet si shkencë e cila përdoret përball jo shkencës . Shejh Shaeraviu e kundërshton fuqishëm, gjë që për këtë ka plotësisht të drejtë sepse për dallim nga fetë tjera, në islam ky term nuk përdoret përball islamit.

Arsyetimi në këtë rast është I shëndoshë nëse çështja e shkencës (sekularizmit) është e kundërta e islamit, sepse islami nxitë për shkencë tërë njerëzimin.

Mirëpo sekularizmi te shkencëtarët përafërsisht është terminologji e cila përdoret kundër paditurisë (inJORANCËS) apo me fjalë tjera injorim feje, pra është në tërësi kundër diturisë (shkencës) apo njohurisë fetare. Kjo terminologji është përkthye bukalisht nga gjuha latine te francezët ose te anglezët. Ndërsa përkthimi I fjalës „Alem” që ka të bëjë për botën, pra për këtë botë (ose kohëtarët). Ndërsa kjo terminologji është e hershme të cilën e ka potencuar edhe vetë Kur’ani ku thotë: Dhe thane: Nuk është asgjë tjetër kjo botë përpos që lindim, vdesim dhe nuk na shkatërron asgjë tjetër pos koha. Për këtë nuk kanë kurrfarë njohurie. Ata vetëm se imagjinojnë.

Kjo është prej emërtimeve tradhtarë të cilën e kanë përdorë jahuditë për të vallëzuar ata me fenë e tyre nëpërmjet cionizmit ndërkombëtarë me të cilin emërtim i

kanë mashtruar kryengritësit e Francës pastaj edhe Ataturkun, e pastaj nëpërmjet asaj kryengritje e kanë përhapur në tërë rruzullin tokësor. Ata interesohen vetëm për këtë botë dhe fenë e lënë në tërësi pas shpine. Nëse një fe bie ndesh me epshin apo me këtë botë ajo fe duhet të eliminohet.

Kjo ka qenë domosdoshmëri në kohën e errësirës shkencore në Evropë kur kisha ka refuzuar çdo kënaqësi të kësaj bote. Ky problem nuk ka ekzistuar në islam për të çrrënjosë kënaqësinë e kësaj bote për fitimin e botës tjetër. Dhe kërko atë që Allahu ta ka dhanë hise për në botën tjetër e mos e harro hisen tënde të kësaj bote. Dhe bënë mire ashtu siq të ka bë mire Allahu ty.

EL-KASAS

Lus Allahun që të bëjë dobi nga ky angazhim të këtij djaloshi bashkëkohorë dhe profesorëve të tij dhe shtoj dituri për Allahun. Lus Allahun që Shejhit të nderuar ti jap shëndet, lumturi në jetë.

Dr. Ibrahim Muhamed Betaviju
Ish profesor I universitetit të Ez-herit
DARUL-INSAN KAJRO

KAJRO 13 DHUL Kaëde 1402
1 Shtator 1982

VETËPRANIMI DHE VETËDORËZIMI NDAJ ALLAHUT

Pyetje: Vetëpranimi dhe vetëdorëzimi ndaj Allahut; cila është rruga e cila të shpie deri aty?

Përgjigja: Kur njeriu i ka në dispozicion shkaqet e ndryshme të jetesës e harron shkakvendosësin dhe mendon se ai është vetë, njeriu i cili i ka sjellë ato shkaqe me angazhimin dhe punën e tij. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Jo, kurrsesi jo. Nuk ka dyshim se njeriu e tejkalon dhe bën krim (që nga momenti) kur e sheh veten se është i pavarur” Po sikur ta kujtonte njeriu se për çdo shkak, shkakvendosës është Allahu i Lartmadhëruar, kjo është vetpranim dhe vetëdorëzim ndaj shkaqeve. Kur njeriu sheh se në krahasim me veten e tij, të gjithë njerëzit janë më të mirë se ai në punë të mira, ndërsa vetë bën më së shumti punë të këqija. Çdo njeri e di se e keqja është e keqe, por ai mendon se edhe të tjerët bëjnë të këqija.

O keqbërës mos u krekos me atë se edhe të tjerët bëjnë punë të këqija. Ti shiko çdo njeri me vlera dhe thuaj: Ai është më i vlefshëm dhe më i mirë se unë. Nëse shikon dhe sheh njeri të poshtër dhe me të këqija, ta dish se ti ke të këqija më shumë se ai. Kjo të ndihmon që të mos e mashtrosh veten tënde. Je mashtruar nëse ti mendon se je më i mirë se të tjerët. Me një fjalë vetpranim dhe vetëdorëzim ndaj Allahut është që ti të kesh bindje të plotë se nuk ka forcë e as fuqi që dikush të ndryshojë diçka pos Allahut. Dhe ta ushtrosh veten në fjalën e Zotit të Lartmadhëruar “Asnjë njeri (apo popull) mos ta nënçmojë tjetrin duke menduar se ai është më i mirë prej tjerëve”. Allahu për t’ia tërhequr vëmendjen njerëzve i jep atij i cili nuk mashtron që të habitet ai i cili mashtron. Mirëpo, Zoti i Lartmadhëruar këtë çështje nuk e bën absolute, apo të përgjithshme, se atëherë të gjithë njerëzit i kishin pasuar vetëm shkaqet.

Pra, ne duhet që gjithmonë ta kujtojmë se Allahu i Lartmadhëruar është shkakvënës dhe dhurues i shkaqeve. A është e qartë tani çka do të thotë vetpranim dhe vetëdorëzim ndaj Allahut.

EL-LIANË (MALLKIMI)

Pyetje: Çka është Liani?

Përgjigja: Lianë quhet atëherë kur burri e akuzon bashkëshorten për tradhti të kurorës, e nuk ka dëshmitarë, pos vetes. Kështu ai dëshmon dhe përбетohet katër herë se është e vërtetë dhe ai vetë e flet të vërtetën, ndërsa të pestën herë përбетohet se nëse gënjën dhe nuk e flet të vërtetën, mallkimi i Zotit çoftë mbi të.

Pas kësaj në çfarë situatë të mbesë gruaja. Me këtë a të marrin vendim të prostitucionit? Nëse heshtë ndaj përбетimit të burrit të saj. Vërtetohet se ajo ka tradhtuar kurorën e saj. Mirëpo nëse sdëshmon dhe përбетohet në Zotin katër herë dhe në të pestën

thotë: Nëse ai e flet të vërtetën mallkimi i Zotit çoftë mbi veten e saj. Kështu ajo e mbron akuzimin. Vetëm se jeta bashkëshortore mes tyre përfundon dhe bëhet ndarja mes tyre, e cila quhet ndarje liani (mallkimi). Kështu mes tyre çdo gjë mer fund dhe llogaria është te Allahu.

Ajeti i Lianit (mallkimit) ka zbritur atëherë kur njëri prej sahanëve e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Nëse unë hy në shtëpi dhe takoj një burrë me gruan time, a t'i lejoj në atë pozitë deri sa t'i sjelli katër dëshmitarë? Atëherë ka zbritur ajeti i Lianit.

Ne vërejmë se ndonjë njeri e mallkon veten, duke thënë: Mallkimi i Zotit çoftë mbi veten time nëse gënjen, ndërsa gruaja thotë: mallkimi i Zotit çoftë mbi veten time nëse burri i saj e fletë të vërtetën. Kjo nga shkakun se akuzimi në gruan për prostitucion është me e rëndë se akuzimi në burrin, sepse prostitucioni i gruas është shkak i të ngatërruarit apo përzierjes së trashëgimitarit.

DËRGON SALAVATE PËR PEJGAMBERIN

Pyetje: Si të dërgoj salavate për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe si të dërgojmë?

Përgjigjja: Allahu i Lartmadhëruar i ka urdhëruar robërit besimtarë për të dërguar salavate për Pejgamberin s.a.v.s. kur ka thënë: “Është e vërtetë se Allahu dhe Melekët e Tij dërgojnë salavate për Pejgamberin. O ju që keni besuar, dërgoni salavate për të dhe përshëndeteni me selam”. (El-Ahzabë, 56)

Rrënja e fjalës “Salavat” është lutje, mirëpo kur të cilësohet, atëherë merr emër terminologjik, e ajo është falja apo namazi, i cili e ka fjalët (lutjet) e posaçme, të cilat i fillojmë me tekbirë dhe i përfundojmë me teslim.

Ti nuk e thirr njeriun, përpos kur atij t'ia dëshiron të mirën dhe nuk e thirr askënd tjetër pos atë i cili ka mundësi për të ta sjellë atë të mirë. Nëse ai të cilit i lutet ka mundësi për të të sjellë të mirë, ai të jep të mirën menjëherë . Për këtë arsye salati (lutja) prej Allahut është mëshirë e përnjëhershme, sepse Allahu nuk lut askënd për t'i dhënë diçka, mirëpo Ai vetë është dhënësi. Për këtë arsye lutja e Allahut është mëshirë e përnjëhershme. Që do të thotë se kuptimi “Ai lutet (jusalij) për ju” është: “Ai ju mëshiron ju”.

Lutja e melekëve është lutje e pranuar, sepse dua e tyre është e pastër dhe nuk refuzohet.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Dhe lute për ta, se vërtet lutja jote është qetësim për ta, ka pasur për qëllim: “Lute Allahun për umetin tënd, sepse dua e Pejgamberit për umetin e tij do të jetë qetësim për ta.

Ndërsa salavatet tona për të Dërguarin s.a.v.s. nuk është për t'i sjellë të mira atij, për të sjellë mirësi në veten tonë, sepse çdo e mirë që i shkon Pejgamberit s.a.v.s. ajo mirësi kthehet te umeti i tij. Që do të thotë: Që ne kur dërgojmë salavate për të, ne lutemi për të mirën tonë. Nëse ti dërgon salavate një herë Allahu t'i sjellë dhjetë të mira. Kur kërkojmë që Muhamedi s.a.v.s. të arrijë shkallën e lartë (mekamin mahmur) dhe shefaatin, ne kërkojmë që të përfitojmë prej asaj shkalle, sepse Pejgamberi s.a.v.s. me atë shkallë do të ndërmjetësojë për ne në botën tjetër, që Allahu të na sjellë të mira. Për këtë arsye kur të lutem për Pejgamberin s.a.v.s. jam lutur për veten time.

Sa i përket formës së salavatit, për të kryer obligueshmërinë mjafton të thuhet: “Allahume sal-li alen-nebij ve sel-lim”. Kjo formë është formë e tekstit të Kur'anit fisnik. Ndërsa, sa i përket asaj se ti ke ndjenja dhe dëshiron që Pejgamberin s.a.v.s. ta nderosh edhe më shumë, përshëndete si të duash, dhe çka e ndien ti se është mirë. Ne e kemi pa se si ka qenë i ndikuar për Pejgamberin s.a.v.s. kur ka thënë një njeri: “O Zoti im, për shkak të respektit që ka te Ti, për shkak të vendit që ka te Ti, për shkak të dashurisë që ka te Ti

dhe dashursë që ke te Ai dhe të fshehtat që i keni mes vete (e ne nuk i dimë) të lutemi për salavate dhe selame për të, për familjen e tij, shokët e tij. O Zoti im, shtoj dashurinë time ndja, tij, më mëso për personalitetin dhe gradën e tij, më bashko me të, më bën të kënaqem me shikimin në të, më afro me të, më përgatit që të flas me të, dhe largoi nga unë perdet, pengesat dhe sendet që qëllojnë mes meje dhe tij. Forcoje dëgjimin tim që ta dëgjoj dhe ta përjetoj kënaqësinë e të folurit të tij, dhe më përgatit të takohem me të, dhe të përfitoj prej tij. Dërgimin e salavatit tim bëre dritë shpërthyesë, e cila fshinë çdo errësirë dhe padrejtësi, çdo dyshim, çdo idhujtari, çdo shpifje, dhe çdo padituri para se ta përfundoj këtë dua.

Disa thonë: “O Zoti im! Dërgo salavate për zotërinë tonë Muhamedin, çdo salavate të cilën të dëshiron t’ia dërgojmë dhe në çdo kohë. O Zoti im dërgo selame për zotërinë ton Muhame dhe çdo selam që Ti dëshiron t’i dërgohet dhe në çdo kohë, salavate dhe selame të përgjithmonshme, aq sa vetëm ti di, vlerësoje aq sa vetëm ti di, me vlera të shumëfishta”.

Ne veç e dimë se si i influencuar një arab, i cili, përderisa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte ulur me të, duke e kujtuar Allahun i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: “O zotëria ynë, o i Dërguar i Allahut, unë nuk di të lutem me lutjen si lutesh ti dhe si lutet Muhadh bin Xhebeli, unë e di vetëm këtë: La ilahe il-lall-llah, Muhamedun resulull-llah. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: Po edhe ne rreth kësaj çështje lutemi. Për këtë arsye mjafton me thënë: Allahume sal-li alen-nebij ve sel-lim”.

KADAJA DHE KADERI

Pyetje: Çfarë dallimi ka Kadaja prej Kaderit?

Përgjigjja: Kadaja është vendim për të cilën nuk kam të drejtë zgjedhjeje apo dëshirë në të, ndërsa kader do të thotë që t’i e ke paraparë që t’i ndodhë kjo, dhe çështjet ndodhin ashtu siç e ke paraparë. Nëse ministri i bujqësisë shkruan raport për pambukun ku në mes tjerash thotë: Ne do të mbjellim kaq fidane, një fidan do të jep fryte kaq, prodhimi mesatr i fidanit është kaq. Ne kemi planifikuar që sivjet rezultati i prodhimit do të jetë kaq. Ai planifikon se e ka ditur, ndërsa dijetari mund t’ia qëllojë, e mund të gbojë në kushte dhe rrethana, të cilat nuk i ka ditur. Mirëpo kur Zoti i Lartmadhëruar përcakton dhe planifikon ajo edhe ashtu ndodhë dhe çështjet në gjithësi ndodhin vetëm ashtu siç ka përcaktuar dhe planifikuar Allahu.

Kadaja është në çështje në të cilën nuk kam të drejtë zgjedhjeje, si p.sh. sëmundja dhe vdekja. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka planifikuar të veprojë në punë prej çështjeve në të cilat kam të drejtë zgjedhjeje Ai nuk më ka detyruar ta kryejë, mirëpo Ai e ka planifikuar dhe e ka ditur me diturinë e Tij të përhershme pa fillim se unë do ta zgjedhë atë rrugë.

Nëse unë e dërgoj shërbëtorin që të blejë për ty një gotë, e të them ty: Ai është vonuar, sepse në rrugë ka takuar një djalë dhe ka luajtur me të, e duke luajtur i ka humbur të hollat, dhe tani ai frikësohet të vjen. Unë e them këtë, përderisa gjatë gjithë kohës kam qenë me ty në dhomë, e pas kësaj vjen shërbëtori. E kur e pyesim, ai na përgjigjet: saktësisht ashtu siç kam thënë. Tani pasi që të kam treguar se çka ka me ndodhur, dhe ashtu ka ndodhur, a mos kam dërguar ndonjë forcë për të treguar çka ka vepruar. Atë që kam thënë e kam thënë se i kam ditur gjërat më herët, mirëpo nuk e kam detyruar të veproj atë që të kam thënë.

Kështu (Allahu është shëmbëlltyra më e larta) Allahu e ka ditur nga herët, se si do

të jetë puan me robin e tij dhe e ka shkruar, por jo me detyrim, por në bazë të diturisë së Tij, se si do të jetë puna me robin e Tij. Kjo është kaderi i tij.

Dallimi në mes të dy formave është se dituria njerëzore është ndryshe nga dituria e Allahut. Është e mundur që unë e di se si vepron ky shërbëtor, mirëpo kësaj radhe mund të lajthit për shkak të rrethanave tjera, si f.v. ndonjë automjet e shkel dhe ai shkon në spital, dhe nuk realizohet ajo çka kam thënë unë për të. Ky është gabim i diturisë sime. Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar me diturinë e Tij nuk gabon kurrë. Çoftë i lartësuar Ai me cilësitë dhe emrat e Tij. Nuk ka zot tjetër pos Tij.

GODITJA E FATKEQËSISË

I nderuari Imam, çka do të thotë “Musab” dhe në kuptimin e vërtetë të fjalës çka do të thotë “fatkeqësi”. Dhe sikur e dimë është lutur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. sipas tekstit i cili është gjurmuar prej tij “O Zoti ynë, mos lejo fatkeqësi në fenë ton, mos lejo që jeta në këtë botë të jetë qëllim kryesorë,. Na bën që në jetën tonë të na shtohen të gjitha të mirat, na bën që vdekja jon të jetë e qetë ndaj çdo të keqe. Dëshirojmë dhe shpresojmë që imami i nderuar të na sqarojë këtë çështje, paraprakisht lusim Zotin ta shpërblejë me të gjitha të mirat.

Përgjigjja: Në hadithi kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë: Pasha krenarinë dhe madhërinë Time, nuk e kisha nxjerrë robin në këtë botë pa ia dëshiruar atij të mirën dhe deri sa mos ta kisha paraparë për ta shpërblyer për të mirat, dhe për ta pastruar prej të këqijave të tij, i sjellë atij sëmundje në trup, pakësim në pasuri dhe humbje në fëmijë dhe kur ti mbetet vetëm një e keqe pastrohet me agoninë e vdekjes që në ditën e kijametit të paraqitet para meje i pastër prej gabimeve sikur atë ditë kur ka lindur prej nënës së tij. Pasha krenariën dhe madhërin Time, nuk e kisha nxjerrë robin tim në këtë botë, për t’ia dashur të keqen, pos ajo e keqe, e cila është kompensim për veprat e këqija duke i dhënë shëndet në trupin e tij dhe shtim të pasurisë dhe të fëmijëve, e kur t’i mbetet vetëm një e mirë e peshon agonia e vdekjes, ashtu që në ditën e kijametit nuk do të ketë me vete asnjë të mirë.

Për këtë arsye, kur Pejgamberi s.a.v.s. është pyetur për atë të cilin e godet ndonjë fatkeqësi është përgjigjur: Nuk është fatkeqësi ajo që ju po mendoni, por fatkeqësi është kur ti je i pashpërblyer, apo i penguar prej shpërblimit.

Ndërsa atë që e godet ndonjë fatkeqësi, e ai duron me vendosmëri, a mund të quhet fatkeqësi? Natyrisht se jo. Përkundrazi ajo fatkeqësi është shpërblim për të.

POLEMIKA DHE DISKUTIMI I TYRE ËSHTË MËSHIRË

Pse katër medhhebe (katër drejtime) dhe ndryshimi mes tyre?

Allahu i Lartmadhëruar e ka zbritur Islamin për të vendosur programin e aktivitetit jetësor. Vendi në të cilin ka zbritur është vendi i sundimit të aktivitetit të jetës, pra për të vendosur aktivitetin e jetës së njeriut, e sa i përket gjallesave dhe çështjeve pas njeriut ata i nënshtrohet ligjit të domosdoshmërisë dhe ata nuk mund të ndryshojnë asgjë.

Cili është shkaku dhe arsyeja se për njeriun është vendosur programi. Vepra, ose mos vepra, ndërsa të gjitha çështjet tjera i janë të nënshtruara ligjit vepra, pra programit pa të drejtë zgjedhjeje. Sepse njeriu posedon mjetet e zgjedhjes dhe mjetin shqyrtues (zgjedhës) ai mjet është mendja. Kuptimi “zgjedhje” dhe “shqyrtim” do të thotë se ka

çështje të ndryshme dhe të lloj-llojshme, e mendja e zgjedh njëren prej tyre. Pra mjete shqyrtues – zgjedhës (mendja) dhe në mes janë sendet që duhet zgjedhur ekzistojnë. Kur nuk ka mjete për të zgjedhur nuk ka vend për zgjedhje, e kur të gjinden mjete për të zgjedhur e nuk ka vend për zgjedhje, e kur të gjinden mjete për të zgjedhur e nuk ka mendje, si p.sh. i çmenduri, atëherë nuk ka edhe kërkim për obligueshmëri, pra ai i cili nuk është i pjekur psikikisht! Pra, në zgjedhje patjetër duhet të jenë dy anët: mjetet të cilat duhet zgjedhur dhe mjete të cilat zgjedhë (zgjedhës). Po ashtu duhet që njeriu të jetë i lirë në zgjedhje mes mjeteve pa qenë i detyruar. Nëse gjindet ndonjë forcë e cila e detyron të veprojë diçka pa dëshirë dhe pa lënë alternativë për të zgjedhur në themi se për të nuk gjykohej dhe nuk i mirret parasys.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka vendosur sheriatin Islam që i ngarkuari me obligime të ketë të drejtë zgjedhjeje të njeriu janë vërejtur dy çështje. Ë një anë është i detyruar në anën tjetër jo. Çështjet kryesore të përgjithshme Allahu i ka bërë obligative me vendim. E nuk i ka lënë hapësirë njeriut për të zgjedhur.

Këtë e ka bërë se njëllojshmëria është qëllimi që vetëm ashtu është në rregull. P.sh. Lëvizjen e trupave qiellor në gjithësi. Atë çka Allahu ka dëshiruar të jetë e qartë e ka bërë të përpiktë. Në ta nuk ka kundërshtime. I ka bërë obligative pesë kohët e namazit,. Këtë askush nuk e kundërshton. Askush nuk ka thënë se janë katër e tjetri të thotë p.sh. shtatë. E pastaj ka thënë: Sabahu i ka dy rekate, në këtë askush nuk ka kundërshtuar. Pra, në çështjet kryesore obligative Allahu nuk ka lënë hapësirë për hulumtim (ixhtihad), por ka dhënë urdhër të prerë.

Kjo prezanton anën e domosdoshmërisë të njeriu, ai është i obliguar të jetë ashtu. Allahu ashtu ka vendosur pa i lejuar njeriut të bëjë ixhtihad. Gjithashtu Zoti i Lartmadhëruar në çështje të brendshme të vendimeve ka lënë hapësirë për ixhtihad (hulumtim). Kështu që çdo gjë çka zgjedhur njeriu është ajo çka ka dashur Zoti i Lartmadhëruar. P.sh. Nëse fëmijës tim ia jap një lirë sterline (xhunejl) dhe kërkojë prej tij të blej pemë, mirëpo unë atij i kam lejuar të zgjedhë ose mandarinë ose portokaj të thartë ose portokaj të ëmbël. Çfarë do që të blejë ai nuk ka dalë jashtë kornizave të kërkesës sime, mirëpo ai nuk ka të drejtë të blejë banane, ose çaj ose sheqer, sepse ai atëherë ka dalë jashtë kornizave të kërkesës sime. Për këtë arsye nuk ka çka të mendojë dikush se dijetarët (imamët) kanë kundërshtuar në çështjet bazore që Allahu i ka dëshiruar të jenë të pakontestueshme. Atë që Allahu ka dëshiruar të jetë e pakontestueshme aty kurrë nuk do të ketë mospajtime. Çështjen e pakontestueshme e ka lënë ashtu, se po mos të ishte ashtu do të prishej çështja në tërësi. Ndërsa çështja e cila në të dy mënyrat është në rregull, apo në tri mënyra e më shumë e ka lënë të paqartësuar për t'i lënë njeriut lirinë e zgjedhjen në të, sepse Allahu është ai i cili ka krijuar njeriun njeriut t'ia imponojë çështjet sekondare, por ia ka lejuar që të zgjedhin dhe të bëjnë hulumtim dhe ixhtihad në suaza të tekstit të përgjithshëm. Po ashtu edhe sahanët kanë prezantuar me Pjergamberin s.a.v.s. në bazë të kushteve dhe rrethanave të secilit prej tyre në kohë të ndryshme të ditës dhe natës. Dhe që të gjithë nuk janë bashkuar që të prezantojnë në një kohë të caktuar, ashtu siç është në shkollë në të cilën dyert hapen në mëngjes dhe mbyllen në mbrëmje dhe secili prej studentëve arrin shkollë të diturisë në bazë të aftësisë së tij. Mirëpo secili prej sahanëve ka përfituar diçka e tjetri diçka tjetër, varësisht prej kohës në të cilën ka qenë prezent te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Nëse ndonjëri prej sahabëve ka prezantuar në kohën kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka vepruar në këtë mënyrë, ndërsa tjetri thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka vepruar në këtë mënyrë. Mirëpo çështja është se Pejgamberi s.a.v.s. a ka vepruar siç thotë ky sahabë dhe nuk ka vepruar siç thotë sahabiu tjetër.

Për këtë arsye përkrahësit e dijetarëve thonë se kanë transmetuar për atë çështje se

kanë prezantuar te Pejgamberi s.a.v.s. në kohëra të ndryshme. Është e mundur se kjo lejon që dispozita apo mënyra si ka vepruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është dispozita apo mënyrë të cilën Allahu e ka lejuar për robërit që të zgjedhin, të hulumtojnë dhe të bëjnë ixhtihad për të.

Kështu pra, mendimet e ndryshme janë rezultat që Ligjvënësi i ka lënë me qëllim në ato çështje, argument për këtë kemi se Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Po të ktheheshin te Ai (Allahu) dhe te i Dërguari i Tij, dhe te ata të cilët janë emëruar udhëheqës për ta prej tyre, do ta kishin mësuar ata se çka ka rezultues prej tyre”.

Kur Pejgamberi s.a.v.s. e ka përfunduar betejën “Ahzabë” dhe ende nuk i pat ndërruar rrobat e luftës dhe i thonë shko te fisi Beni Kurejdha, mos i hiq fare rrobat e luftës dhe përgatitjen luftarake, përderisa t’i nënshtrosh dhe t’i edukosh ata. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Kush beson në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, mos ta falë ikindinë pa arritur te fisi Beni Kurejdha”. Pastaj Sahabët kanë kundërshtuar mes vete: Disa kanë thënë: Namazi i ikindisë nuk lejohet askund tjetër, pos në fisin Beni Kurejdha, mirëpo gjatë rrugës, pasi djelli ishte afër perëndimit disa tjerë kanë thënë: I dërguari i Allahut s.a.v.s. vetëk ka dashur të na shpejtoj, mirëpo ne veç pasi që jemi vonuar nuk kemi arritur atje, duhet ta falim ikindinë me kohë. Kështu që disa e falin ikindinë pa arritur te fisi Beni Kurejdha, në rrugë të tjerët e falin pasi që arrinë te fisi Beni Kurejdha. Kështu ky është argument se që të dy mënyrat janë të lejuara. Mirëpo nuk ka dyshim se të gjithë dëshirojnë namazin ta falin. Mirëpo ka ndoshtur mospajtimi në kohë dhe vend. Kur Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë falja të bëhet vetëm te fisi Beni Kurejdha, ka përcaktuar vendin. Kur tjetër e kanë pa se dielli veç do të perëndojë para se të arrijnë në atë vend koha kaloi në elementin kohorë jo të vendit. Kështu që disa shikuan elementin e kohës të tjerët elementin e vendit. Kur i kanë treguar Pejgamberi s.a.v.s. se si kanë vepruar e ka lejuare edhe të parën edhe të dytën.

Për këtë arsye, edhe ka qenë ixhtihadi i dijetarëve, sepse Allahu ka dëshiruar që ne të bëjmë ixhtihadë. Allahu nuk ka dëshiruar që të gjitha dispozitat të jenë të padiskutueshme, e të mos i lejojë njeriut liri të ideve dhe të mendimit, e që të mos ketë dijetarë për të hulumtuar e për të bërë ixhtihadë pasi që veç e ka lejuar ixhtihadin. Shembull për këtë kemi ajetin e abdesit. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: Kur të falni namazin pastroni fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla”.

Kur Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë obligim pastrimin e fytyrës nuk e ka caktuar deri ku. Parashtrohet pyetja pse? Për arsye se arabët asnjëherë nuk kanë kundërshtuar në përcaktimin e fytyrës, mirëpo dora po. Disa mendojnë se dorë quhet pjesa deri në unazën e shuplakës, të tjerët e quajnë dorë tërë pjesën deri në qafë, pra tërë krahun, të tjerët e quajnë deri në shpatulla, mirëpo Allahu ka dëshiruar deri në bërryla. Pra, kur Allahu dëshiron të përcaktojë diçka, Ai përcakton dhe i mbyllë dyert e kundërshtimeve. Po nëse Allahu nuk do ta kishte përcaktuar deri në bërryla dhe secili dijetarë do të bënte ixhtihad, ne secilit muxhtehid do t’i thonim: Ixhtihadi i juaj është në rregull. Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Lëmoni në kokat tuaja”. Kështu ka laluar prej pastrimit i cili është përfshirja e fytyrës me ujë në mes-h (lëmim) me ujë, por pa përfshirje dhe stërpikje e tërësishme. Pse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Lëmoni në kokat tuaja”. Pse po të kishte thënë: “Lëmoni kokat tuaja” nuk do të kishte pasur vend dhe hapësirë për ixhtihad|

Po të kishte dashur Allahulëmimin e një të dytës së kokës apo një të katërtës së kokës do ta kishte thënë këtë. Mirëpo Ai e ka përdorë pjesëzën “në”, e cila lejon kuptime të ndryshme dhe secili që i jep një kuptim prej kuptimeve të shumta të pjesëzës “në” ai veç iu ka përmbajtur tekstit kur’anor.

Pra, kur dijetarët bëjnë ixhtihad, ata shkojnë në atë çka nënkupton teksti, pra në të

kuptuarit e vetë tekstit.

Ndërsa sa i përket pasimit (përmbajtjes së këtyre medhhebeve) themi: Ai i cili ka mundësi të kuptojë çdo rregull ai të mos i përmbahet vetëm një medhhebi të caktuar, por ashtu siç e parasheh vetë ai prej tekstit dhe i jep përparësi atij vendimi përderisa është i aftë për të bërë ixhtihad dhe posedon mjetet e ixhtihadit prej diturisë së përfituar nga Kur'ani dhe diturisë së fituar nga suneti. Mirëpo ai i cili nuk është i aftë dhe nuk ka mundësi të ixhtihadit ai pason atë medhheb të cilit i beson me diturinë e tij. Medhhebi i tij është medhheb i muftisë së tij se kur ndonjëri e di se dikush është emëruar në post të asaj detyre, apo njerëzit e dinë se ai është i specializuar në atë drejtim, e pyet për çështjet e fesë së tij.

Mirëpo, janë paraqitur katër medhhebet dhe i kanë përfshirë të gjitha çështjet dhe askush më nuk ka pasur mundësi të bëjë ixhtihad dhe e kanë pasuar vetëm në medhheb dhe të gjithë kanë dhënë mendim prej tekstit në të cilin kanë bërë ixhtihad. Përderisa Ligjvënësi ka lënë hapësirë dhe vendos ligj për të bërë ixhtihad, atëherë ligji vendimi është prej tij dhe çdo gjë që arrin muxhtehidi është e vërtetë, si p.sh. shembulli i portokallit. Përderisa jemi pajtuar për atë që është bazë, ndërsa për sekondaren e kemi lënë të pasqaruar, atëherë atë çka e arrin muxhtehidi është e rregullt. Vallahu tala ealem.

BISEDA ME SHPIRTRA

Pyetje: Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me kontaktimin me shpirtra dhe shërimin me shpirtra?

Përgjigjja: Duke sqaruar Shejh Shaëraviju këtë çështje thotë: “Kush i ka mësuar ata se ata janë shpirtra? A mos e dinë ata shpirtin para se t’u vjen atyre. Thonë: Këto janë shpirtra të cilat i dimë dhe i njohim.

Ata munden të thonë: Atyre u vjen një forcë e fshehtë, ndërsa shpirtra jo. Kjo është e papranuar. Më këtë çështje janë marrë njerëzit prej kohërave të lashta. Kjo veprimtari nuk ka ndodhur përnjëherë, përkundër asaj se shkencat tjera janë zhvilluar dhe kanë përparuar vrullshëm çka tregon sse ata hulumtojnë në terr dhe pa fakte, sepse hulumtimi shkencor ka nevojë për përvojë dhe eksperiencë, ndërsa kësaj veprimtarie nuk i nevojitet as përvoja as eksperiencia.

Ai, i cili thotë se kontakton me shpirtra nëpërmjet Kur'anit fisnik, ai është gënjeshtar i kulluar dhe mashtrues. E gjithë kjo arrihet nëpërmjet fallit, magjisë duke kontaktuar xhinë.

Pastaj imami i nderuar vazhdon e thotë: Ata të cilët thonë këtë për veten e tyre dhe thonë se bisedojnë me shpirtra shohim se janë më të vështirët dhe më injorantët dhe më të këqijtë në jetën e tyre dhe asnjëri prej tyre nuk vdes me të mira. Pasurinë e tyre e merr ai të cilin ata nuk e njohin. Ky është argumenti më i forti se ata nuk mund t’i bëjnë dobi as vetes së tyre. Pastaj, veprimtaria e tyre me njerëz i lodh ata. Njerëzit duhet t’i dinë dhe t’i kuptojnë aftësitë e tyre, dhe duhet ta dinë se Allahu e ka fshehur të fshehtën prej tyre, prej mëshirës që ka për ta. Nëse njëri e di se do t’i ndodhë ndonjë fatkeqësi, ai do të pëlças dhe do ta zmadhojë atë fatkeqësi dhe tërë jetën e tij do ta bëjë të keqe dhe të vështirë. Ai, i cili më tregon dhe më informon për një fshehtësi të cilën nuk mund ta tejkalojë, çka përfitoj unë atëherë prej asaj informate?!

ISTIGFARI, HAXHI DHE FSHIRJA E MËKATEVE

A duhet kërkuar falje për çdo mëkat veç e veç, apo të kërkohej falje për të gjitha mëkatet në përgjithësi?

Dhe sa është e vërtetë fjala: “Haxhi i fshinë të gjitha mëkatet, sepse haxhiu kthehet i pastër prej mëkateve ashtu siç ka lindur prej nënës së tij?”

Përgjigjja: I nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Jo, ai duhet të kërkojë falje për secilin mëkat veç e veç, mirëpo ndonjëherë i kujtohet gabimi, e ndonjëherë nuk i kujtohet ndonjë gabim, atëherë kur nuk i kujtohen kërkon falje për të gjitha gabimet. Çdo herë kur qanë për ndonjë gabim ai gabim i shndërrohet në punë të mirë dhe çdo herë kur e lëndon gabimi, apo ndien dhimbje për atë gabim dhe kërkon falje i shndërrohet në punë të mirë. Kjo është domethënia: Allahu punët e këqija të tyre ua shndërron në punë të mira. Mirëpo, duhet ta dimë se Allahu i falë gabimet, të cilat janë bërë ndaj Tij, ndërsa gabimet, të cilat kanë të bëjnë me robërit e Tij, patjetër duhet pastruar me robërit.

Ndërsa, mëkatet, të cilat nuk i kujtohen, që i ka bërë ndaj robërve ne e kemi mësuar se duhet të bëjë këtë lutje: “Kërkoj falje nga Allahu i madhërishëm për mua, për prindërit e mi dhe për ata të cilëve u kam bërë padrejtësi”.

MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA

Çka është mëkat i vogël, e çka i madh, dhe a është e mundur që mëkati i vogël të bëhet i madh ndonjëherë?

Përgjigjet Shejh Shaëraviju: Mëkat i madh është idhujtaria, pirja e alkoolit, prostitucioni, vjedhja, vrasja, mosrespektimi i prindërve, shpifja ndaj grave të ndershme, ndërsa përpos këtyre quhen mëkate të vogla.

Përsëritja me qëllim dhe i vazhdueshëm i mëkatit të vogël është mëkat i madh, pra përsëritja dhe vazhdimësia. Kjo është sikurse ti veç ke vendosur për të mos e dëgjuar Allahun, ky mosdëgjim bëhet edhe në mëkatin e vogël, i cili pastaj bëhet i madh, sepse ka kaluar prej kundërshtimit të vendimit, në rebelimin e atij vendimi.

“FLETËT NUK PRANOJNË TË SHKRUHET NË TO, LAPSAT KANË PUSHUAR SË SHKRUARI DHE JANË NGRITUR”

Pyetje: Çfarë kuptimi kanë fjalët: “Lapsat janë ngritur, e fletët janë terur”?

Imami i mirënjohur – Shaëraviju thotë: “*Lapsat janë ngritur e fletët janë terur*” kanë kuptimin se çdo gjë e cila ka për të ndodhur deri në ditën e Kijametit është shkruar në libra dhe nuk mund të ndodhë diçka tjetër pos ajo çka është shkruar. Janë palosur dhe janë terë fletët, ka kuptimin se në to nuk ka për t’u rikthyer dhe të përmirësohet diçka, apo të shkruhet diçka e re, apo diçka tjetër. Mirëpo çdo gjë çka do të jetë në ekzistencë është e shkruar në fletë, sepse Zoti i Lartmadhëruar e ka ditur se çka do të ndodhë në gjithësi. Edhe pse njeriu është i vullnetshëm, ndërsa vendimi në çështjen e vullnetit është argument për diturinë e Tij gjithëpërfshirëse, e nuk e ka kuptimin e të imponuarit, por e ka shkruar se e ka ditur se ashtu ka për të vepruar.

MJETET E MËKATIMIT

Çfarë kuptimi ka fjala e Zotit të Lartmadhëruar: “Atë ditë kur do të dëshmojnë

kundër tyre gjuhët e tyre, duart e tyre, e këmbë e tyre për atë që kanë punuar”?

Përgjigja: Mëkati mund të jetë ose me fjalë ose me vepër.

Mëkati me fjalë është mëkatimi i gjuhës. Mëkati me veprë është mëkatimi me duar, nëse ajo veprë bëhet me duar pasi që të qëllon pranë ose nëse është larg ti duhet të shkosh në këmbë është mëkatimi i këmbëve. Këto janë mjetet e kimit dhe të mëkatit. Gjuha, duart dhe këmbët dëshmojnë kundër njeriut edhe pse vetë ato pjesë janë kryerëse (bashkëpjesëmarrëse) të drejtpërdrejtë të asaj veprë.

Në këtë botë Allahu na ka dhuruar preparatet e trupit, ato janë të nënshtruara dëshirave ton, veprojnë sipas dëshirës sonë, ato nuk pengojnë në kryerje të veprimit pasi që i janë të nënshtruara dëshirës sonë. Mirëpo, në ditën e Kijametit ne nuk do të kemi mbizotërim mbi ta që të veprojmë sipas dëshirës sonë. Dëshira kalon në tërësi te Zoti i Lartmadhëruar. Allahu na ka dhënë trupin si mjet ndihmës tonin në këtë jetë, që të veprojmë me të çka të dëshirojmë që të kemi kompetencë të veprojmë me ta çka të dëshirojmë, mirëpo në ditën e Kijametit askush mbi asgjë nuk do të ketë kompetencë për ta ndihmuar të veprojë çka dëshiron. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar në ditën e Kijametit thotë: I kujt është sundimi sot? Vetëm i Allahut të vetëm, mposhtës dhe mbizotërues (mbi gjithçka). Kështu dëshirën e njeriut mbi pjesët ia heq dhe pjesët (Organet) e tij dhe preparatet pranojnë gjithçka kanë vepruar.

Dënimi nuk bie mbi këta pjesë (organe), mirëpo njeriu ndëshkohet me ta, atëherë ato janë mjeti ndëshkimit të mëkatimit. Shkenca bashkëkohore ka zbuluar dhe ka vërtetuar se dhimbjet nuk ndihen në vetë pjesën e trupit, mirëpo në shpirt. Argument i kësaj është se njeriu ndien dhimbje në çdo pjesë të trupit, mirëpo kur mjeku e merr përsipër të sëmurin për ta operuar, ai gjatë operimit nuk ndien kurrfarë dhimbje gjatë operimit.

NËSE JANË TË VARFËR ALLAHU I PASURON

Cili është mendimi i Shejh Shaëravijut: “Nëse dëshiroj të martohem me një vajzë, e cila i ka të gjitha çka dëshiron djali që t’i ketë vajza, pra është fetare, e moralshme dhe e bukur, vetëm se ajo është e varfër, shokët më këshillojnë që ta zgjedh një grua tjetër, e cila është e pasur, e cila më ndihmon me pasurinë e saj që t’i tejkaloj problemet e jetës.

Përgjigja: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i gjithëdijshtëm”.

(En-Nur, 32)

Pra, mos lejo që pasuria të jetë peshojë në zgjedhje të bashkëshortes, por bëre që të jetë çelës i furnizimit. Në këtë ajet Zoti i Lartmadhëruar ka treguar kushtin dhe përgjigjen kur ka thënë: “Nëse janë të varfër, Allahu i pasuron”. Atë që e thotë Allahu, ajo patjetër duhet të ndodhë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka tërhequr vërejtjen për këtë kur ka thënë: “Kush martohet me një grua se ka famë, fama e saj do t’i kundërvihet, që do të thotë: Nëse qëllimi i atij njeriu ka qenë që të martohet me një femër me famë që të përfitojë prej famës së saj, atëherë në mes të tyre do të ndodhin pakënaqësi dhe armiqësi. E ai e ka zgjedhur në duel armikun e fortë. Kush e zgjedh femrën për pasuri dhe për të përfituar prej pasurisë së saj do ta përjetojë se ajo do të jetë e ngritur, kryelartë dhe gjithmonë e pakënaqur, e cila do ta shpie që të poshtërohet për shkak të pasurisë së saj dhe pasuria e saj do t’ia helmojë dhe do t’ia shkatërrojë jetën.

Pastaj ajeti sjell sqarimin “Allahu është i Gjerë (Gjithëfurnizues), i Pasur dhe i ditur”. Ky ajet tregon se çka është më e përshtatshme dhe më e leverdishme. Përderisa fjala është për atë që ka nevojë njeriu dhe për pasuri Allahu është i Pasur. Atij kurrë nuk i pakësohet pasuria që do të thotë edhe nëse supozojmë se të gjithë njerëzit dëshirojnë të martohen me vajza të varfra, premtimi i këtij ajeti do të realizohet. Allahu do t’i jepte pasuri secilit prej tyre. Mirëpo ne nuk shohim se njerëzit e dëshirojnë këtë. Nëse një njeri i pasur u jep tjerëve prej pasurisë së tij, ne shohim se të tjerët pikëllohen se këtij njeriu do t’i pakësohet pasuria duke iu dhënë të tjerëve.

HERIATI DHE DREJTËSIA

Pyetje :Cili është dallimi mes sheriatit dhe drejtësisë?

Përgjigje:Me shariat kihet për qëllim që të veprosh një qështje e cila ta hjek një vështërsi.Dispozita është paralel me ty(nevojat tua).Para se ta falësh namazin,ti në rend të parë merr abdest pastaj falesh.Të gjithë ne të kemi pa kur e ke kry obligimin dhe askush nuk thot asgjë tjetër pos atë që ka pa.Mirëpo a e ke falur namazin ashtu siq dëshiron Allahu prej teje,apo me atë nijet të cilën Allahu të ka obligu dhe ka dëshiru prej teje.Ti kur e ke marrur abdest dhe je falur,ti i ke kry në bazë të normave të sheriatit dhe në bazë të formës së kërkuar në namaz ,mirëpo qëllimi yt e ka qen të kryerit e një obligimi ndaj Allahut apo vetëm që të proklamohesh.Drejtësi është ta rrespektosh dhe ti kryesh normat e sheriatit dispozitivisht dhe ashtu qysh kërkohet që qëllimi të jet i kryer ashtu siq ka dëshiru Ligjëvënësi.

Sheriati është kryerja e obligimeve në aspekt të jashtëm (formalisht) ndërsa drejtësi është të kryesh në aspekt të mbrendshëm(esencialisht).Drejtësia është sekret mes robit dhe Zotit të tij a i kryen ashtu siq ka ligjësu dhe siq ka dëshiru Allahu,apo ai dëshiron të kryen vetëm formalisht.Pra drejtësi është të arrish në bërthamë të obligimit dhe të thuhet ajo çka është ligjësu dhe nuk është arritur qëllimi i atij ligjësimi është hipokrit.Në kohën e pejgamberit s.a.v.s hipokritët jan ulur në rreshtat e parë,ato nga aspekti sheriatik i kan krye obligimet ,ndërsa e vërteta ka qenë krejtë ndryshe.

Pra ,drejtohu në kryerjen e obligimeve të Allahut ashtu siq do Allahu dhe ashtu siq e ka parapa ,e jo ashtu siq veprojnë të tjerët,edhe ti të veprosh si ata sikurse një kryetar i përpiktë në punën e tij i cili ka ndalu të ngrërërit ,të pirit gjat orarit të punës dhe ai i cili për çdo thyerje të rregullit ka parapa dënime.Pastaj shohim punëtori vjen në kohë ,i përmbahet tëgjitha rregullave të parapara ,ai iu është përmbajt rregullave nga aspekti i jashtëm dhe formalisht e jo në esencë ,pra kryerjen e punës e cila kërkohet prej tij.Kështu pra sheriatit është forma e jashtme e adhurimit ,ndërsa e vërteta është qëllimi i Ligjëvënësit.Ai i cili i përmbahet sheriatit ,ai mund të mashtrij njerëzit,por nuk mund të mashtrij Ligjëvënësin.për këtë arsye ai i cili përmbahet formalisht sheriatit prej tij nuk dalin rrezet e shkëlqimit ,ndërsa ai i cili përmbahet thelbësisht ai shkëlqen prej tij burojn rrezet e dritë.

IMANI DHE EPSHI

Imani ndikon drejtëpërsëdrejti në edukimin shpirtëror dhe të ndjenjave të mbrendshme.Cili është roli i tij.Mirëpo a nuk bien në konflikt mes vete kërkesat e epshtit njerëzor dhe besimit dhe karakterit të lartë të tij.A nuk është ky faktor permanent për ti dallu njeriu cilat jan kërkesat e trupit dhe cilat jan kërkesat e shpirtit,shpresojm që Imami i mirënjohur do të na sqaroj që të na qetësohet mendja?

Përgjigje: Imani është qështja e cila dirigjon ,i organizon dhe ngritë ndjenjat e nuk çrrënjos, pse po t'ishte ashtu bëhet pyetja, atëherë pse Allahu ka kriju ndjenjat. Pra ndjenjat e kanë rolin e tyre ,e islami nuk e bënë që besimtari të ketë zemër të vdekur, ashtu që të përqëndrohet vetëm në një qështje. Qështja e vetme të cilën e kemi përmend edhe më herët është të i nënshtrohet Allahut ,dhe t'i dorëzohet programit të Allahut, e pas kësaj nuk e gurëzon ,por Ai i dëshiron t' ketë ndjenjat mirëpo ato ndjenja t'i lartëson tjetërkush mos t'ia dëmton .Ia ndritë ndjenjat për të pasur pasuri dhe për ta udhëheq atë, e askush tjetër mos ta okupoj. Ia ngritë ndjenjat e epushit për tu martuar që shoqëria të jetë e pastërt dhe e ndershme. Ia ngritë ndjenjat për të kërku forcë që të mos të jet i nënshtruar. Ia ngritë ndjenjat për të kundërzbuluar që të mos jet i spiunuar dhe për tu mos u ndjek të metat e njerëzve.

Pra për çdo ndjenjë prej ndjenjave të njeriut. Islami ç'është për ta zhvilluar e jo për ta ngurrësuar, sepse zhvillimi i ndjenjave e kanë rolin e tyre .Kur njeriu e shikon këtë qështje beson se nje fuqi më e lartë se ai është e cila i ka organizuar këtë qështje.

Sepse ajo është fuqi absolute. Ajo është e cila më ka kriju kjo është e cila më ka pajis me fuqi . Kur njeriu balafaqohet me ndonjë qështje të tyre, nuk do të thot të qëndroj i plogësht por i thuhet atij :Ndonjëher bëhu i rrept , ndonjëher i mëshirshëm , pra ai fuqinë e tij nuk e përdor gjithmon me fuqi absolute ,por ai ,as me mëshirë, sepse po t'ishte vetëm i fortë e i rreptë ka raste kur nevoja e kërkon mëshirësinë ,po t'ishte vetëm i lartë e i ashpër ka rastë kur nevoja kërkon butësi, po t'kishte vetëm një lloj rë cilësisë atëher do t'kishte qenë i penguar të ket cilësi tjetër ,e cila cilësi është e rëndësishme në jetën e tij.

Zoti i Lartëmadhëruar thotë: Të butë për besimtarët ,të fortë e të ashpër për pabesimtarët. Pra ata kanë element nëpërmjet të cilin munden me qenë të fortë, por edhe element tjetër me të cilin munden më qenë të butë. Por kur të jenë të fortë ,e kur të jenë të butë? Kjo është në kompetencën e drejtës së tyre. Bëhuni të butë për vëllezërit tuaj besimtarë, dhe të fortë për pabesimtarët.,, Të fortë për pabesimtarët të mëshirshëm mes vete"

Pra Islami nuk krijon besimtar vetëm të një lloj cilësie ,sepse secila cilësi e ka rolin e vet. Patjetër duhet të ekzistoj fuqi mposhtëse ,intelekte dhe urtësi e cila i ve në binarë këto qështje.

GJUHA ARGUMENT PËR ARGUMENTIMIN E EKZISTIMIT TË ALLAHUT

Pyetje: A mundet të jetë gjuha argumentim për ekzistimin e Allahut?

Përgjigje: Përderisa të gjitha arhumentet ,si argumentim logjik argumentimi shoqëroro-historik, argumenti i ekzistimit të vet njeriut jan argument se ekziston një forcë më e lartë .Ka edhe qështje tjetër ,e cila rralë dëgjohet dhe rrallë për te flitet. Unë habitem si argumentuesit nuk e kanë marrë këtë argument për ekzistimin e Zotit ,përderisa është argument. Po, për të gjithë popujt ,për të gjitha mendjet ,për të gjitha kategoritë e njerzëve. Argumentimin gjuhësor nuk mund ta mohoj askush. Besimi në Zotin është domosdoshmëri gjuhësore. Gjuha është dukuri e kërkuar e njeriut për të jetu në shoqëri sepse në shoqërinë cuvilizuese ,normalisht është domosdoshmëri të ket gjuhë me të cilën kuptohen. Po të kishte vetëm një njeri ,nuk kishte pasë nevojë për gjuhë (të folurit) çdo gjë që i kishte shku ndërmend e kishte vepru. Mirëpo ai, në raport me të tjerët patjetër duhet ti përcjell idetë e tija te të tjerët dhe të dëgjoj idetë e të tjerëve. Pra gjuha është e patjetërsueshme ,kjo gjuhë e ka rolin e saj që të kuptohemi me te. Ne nuk mundemi të kuptohemi mes vete pa gjuhë, dhe ajo gjuhë të jet që folësi dhe dëgjuesi të pajtohen mes vete në kuptimin e fjalëve. Pra është domosdoshmëri ,sepse nëse folësi e thot një fjalë e

dëgjuesi nuk e di kuptimin e asaj fjale ,nuk arrihet te rezultati .Kjo do të thotë se nëse një njeri vjen dhe flet gjuhën arabe mund ta dij dhe ta flas çdo fjalë të kësaj gjuhe,e dëgjuesi ta kuptoj çdo fjalë të tijë.Përkundrazi duhet të dihet kuptimi i fjalës para se të flitet ,në rend të parë e pastaj vjen fjala e cila është arabe mirëpo ai nuk kupton asgjë.Të gjithë e dimë për literaturën e gjuhës dhe të letërsisë.Ne dimë rastin e një personi i cili ka sfidu gjuhtarin e specializuar të quajtur *ALKAM*,duke iu drejtu më fjalë të rralla(të panjohura).Kush është ai i cili ua ka mësu atë nivel që ta kuptoj.Ebu Alkame edhe pse ishte gjuhëtar është tronditur dhe nuk ka kuptu asgjë prej atyre fjalëve:Ebu Alkam zgjohet në mesnatë dhe e thërret djaloshin dhe i thotë:O djalosh :Këtë djaloshi e ka kupt por kur i thotë:„*Escakte Tearifë*“këtë qështje nuk e ka kuptu.Mirëpo djaloshi dëshiron që t'i jap një mësim *ALkames* .Për ta sfidu se ai për së tepërmi krekoset e ia kthenë:„*Dhekialjmë*“.Për herë të parë ndodh që Alkame habitet nuk e kupton çfarë kuptimi ka kjo fjalë dhe i thotë :O djalosh

NGJYRA E ADEMIT A.S.

Pyetje:Ku ka jetu Ademi a.s.,çfarë ngjyre ka pasur,të bardh,të zezë apo të kuqrremt.Dhe si jan nda popujt që e kan një burim prej Ademit a.s. .Shpresojm se do të na përgjigjeni
Përgjigje:Kësaj pyetje mund tju përgjigjemi me një fjalë,dituri e padobi,mosdituri e padëmshme.po të kishte qenë e nevojshme për mua Allahu nuk kishte lënë pa e sqaruar .Pra kjo është vetëm mendim dhe pyetje prej së cilës nuk mund të arrihet te ndonjë rezultat.Kundërpyetja do t'ishte:Po ta kishte ditur çka do të përfitoje prej saj?Çdo qështje të cilën nuk e di është bë me qëllim që ti mos ta dishë,Ai i cili më ka mësu për krijesat e njerëzit është Allahu,e atë që nuk më ka mësuar sikurse nuk është e nevojshme për mua. Sa i përket racave ,ne e dimë shumë mirë ndikimin e diellit ,Jagështise së ajrit në një shoqëri dhe në një mes të cilët banojn në një vend ,dhe si ka ndiku në ndarjen e racave njerëzore në të zi,në të bardh në të verdh etj.Allahu e di më së miri

DISA I KEMI DALLU SHUMË ME GRADA TË LARTA

Pyetje: I nderuari Imam,çfar kuptimi ka ajeti:Ne kemi ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët,që të shfrytëzojn njëri-tjetrin në shërbime .Çfarë ndërlidhje ka ky ajet me ajetin i cili thotë:mos të tallet një njeri(apo popull),në atë mënyrë se ata janë më të mirë prej tyre.A ka ndonjë qështje e cila i bashkon këto dy ajete?Shpresojmë se do t'na sqaroni.Ju falënderojmë.

Përgjigje:TI jeton në shoqëri ,Nevoja jote për individat e shoqërisë është e njëjtë edhe nevoja e individave të shoqërisë për ty.Nëse dëshiron që shoqëria t'i kryej obligimet dhe të plotësoj nevojat për ty,mos kërko të drejta prej shoqërisë pa i kry obligimet tua ndaj shoqërisë.Për këtë arsye pejgamberi s.a.v.s ka thënë :Shembull i besimtarëve në dhembshuri mes vete,dhe mëshirësi e butësi mes vete si shembull i një trupi të vetëm.Mos konsidero veten si tërësi e pavarur prej shoqërisë .Islami kërkon nga ti që ta konsiderosh veten pjesë të tërësisë.

Përderisa pjesa është në tërësi atëherë pjesët kan nevojë për njëra tjetrën për ta kompletuar tërësinë.Pejgamberi s.a.v.s ka dëshiruar që qështjen personale në shoqëri ta bëjë qështje të tërësishme dhe qështjen e personave të shoqërisë të jenë të pjesërishme .Parashtrohet pyetja:pse?Për të mos mendu askush ,që mund të jet i vetmuar dhe i pamvarur ndaj shoqërisë,për këtë arsye ka thënë:Sikurse një trup ,që kur të lëngon një pjesë ,të gjitha pjesët e atij trupit rënkojnë dhe ndiejn dhimbje.Ti nëse shikon shoqërin,e sheh se shoqëria

kërkon aktivitet jetësor,ndërsa aktiviteti i jetës nuk është vetëm i një natyreje.Shoqëria kërkon aktivitet të shumlllojt dhe t'i mbuloj të gjitha nevojat.Shoqëria nuk dëshiron që të gjithë të jeni mjek,ose të gjithë ekonomist,ose të gjithë gjykatës,e as që të gjithë të jenë elektrikistë.Sepse shoqëria nuk duhet të jet vetëm e një drejtimi ,por e të gjitha drejtimeve.Zoti i Lartëmadhëruar *dëshiron* që të gjithë individat e shoqërisë të jenë një trup,ku secila pjesë e atij trupi ta kryej detyrën e vet.Kështu edhe jeta e çdo individ të ket detyrë të posaqshme.Ndonjëherë individ mund të zgjerohet dhe të ket prirje për kryerjen e detyrave të shumta,atëherë ai mbulon një sektor prej sektoreve të shoqërisë,Shoqëria nuk zhvillohet nëse zhvillohet vetëm në një drejtim.Përderisa shoqëria nuk zhvillohet vetëm në një drejtim atëherë edhe dhuntitë duhet të jen lloj-llojshme.Patjetër duhet të shpërndahen ndjenjat dhe prirjen patjetër duhet të shpërndahen punët dhe vullnetet për punë.mëshira e Zotit është se na ka dhënë dhunti të lloj-llojshme dhe vullnet të lloj-llojshëm të drejtimeve.Ky ka vullnet për këtë,tjetri për atë,ky dëshiron këtë e tjetri atë ,etj, etj.Dhe kjo pa u planifikuar prej njeriut ,por është qështje instiktive te çdo njeri veq e veq .nuk ka qytet prej qyteteve që të tubohen të gjithë e të thonë:Ky qytet ka nevojë për kaq shitore,për kaq tregëtarë të mëndafshit,për kaq rrojtore ,për kaq mjek,për kaq advokat.Këtë askush nuk e ka thënë ,dhe nuk është bë një planifikim i tillë.Mirëpo ne shohim se dhuntitë vijnë vet-vetiu.Secila dhunti për një qështje vjen paplanifikuar prej askujt,për të mbuluar nevojat jetësore pa mendu askush.Po nëse njeriu dëshiron të hyjë në ato qështje me mendjen e tij do të ishte çrregulluar.Për këtë arsye duhet shiquar në profesionistin në shoqëri e jo në profesione,sepse nuk ka punë më të mirë se puna e tjetrit por puna profesionale më e mirë se puna e të njëjtit profesion të tjetrit.Pra secila punë mbulon një hapësirë prej hapësirave të jetës ,e cila kërkohet .Njëriu i sinqertë duhet ta merr të drejtën dhe vlerën dhe nderimin e tij në ekzistencë e jo të cilën ia zgjedh dhe ia imponon njeriu.Kjo është veprimtaria (*profesioni*) i lehtë ,madhështorë dhe fisnik ,ndërsa veprimtaria(*profesioni*) në të cilën ia zgjedh dhe ia imponon njeriu është e poshtër dhe nënqmuese.Kto qështje nuk ekzistojnë në fe por ekziston,punëtor i këtij profesioni apo punëtor i atij profesioni vlere e secilit prej tyre mvaret praj asaj si e kryen me ndërgjegjje dhe përsosmëri ,sepse punëtori profesionist kryen një pjesë prej pjesëve të jetës,e kjo është domosdoshmëri.Çdo njeri ka nevoj për tjetrin.Për këtë arsye kur Kur'ani thot:Mos të tallet një njeri (apo një popull) në atë mënyrë se ndoshta ata janë më të mirë prej tyre

EL-HUXHURAT 11

Nuk e thotë :Sepse kur një njeri nënqmon tjetrin ai e ka nënqmuar veten,dhe është nënqmu prej vet tij.Sepse ai sheh një pjesë prej pjesëve e nuk i ka pa pjesët tjera.Kur'ani thotë:Moa nënqmo atë i cili për atë se ndoshta ajo është dhunti e tij,apo ka profesion i cili është i nevojshëm dhe më i vlefshëm për ty.Nëse e sheh një njeri i cili ka të njëjtin profesion tëndin por është më i dobët ,ti kërkoje dhe hulumtoje çfar profesioni të përkryer tjetër ka ai njeri për ta mbulu mangësin të cilën e ka në atë profesion.Atëherë patjetër duhet të jetë një prsoshmëri në një qështje për t'ia mbulu mangësinë në tjetrën dhe patjetër duhet që unë të kem mangësi në atë profesion për ta kompenzu atë përsoshmëri,sepse askush nuk është djalë i Zotit,por për Allahun që të gjith ne jemi të barabart.Për këtë arsye gabojn ata njerëz të cilët i ndajnë njerëzit në kategori.në Islam nuk ka kategori të njerëzve,por ka profesione dhe veprimtari të njerëzve ,secili kryen një sektorë të punës së tij.Islami e vlerëson punën e çdonjërit i cili e kryen me nder .përgjegjësi dhe me përsosmëri.Për këtë arsye ne shohimse njeriu autoritativ dhe i ngritur dhe i pasur kur hyn në shtëpi dhe ndien erë të keqe e pyet për arsyen e asaj ere të keqe e i tregojn se gypat e kanalizimit jan mbyllur,ose për ndonjë arsye tjetër,e ai thotë:Pse nuk sjellni mjeshtrin e gypave të kanalizimit.Ata përgjigjen:Nuk e dimë se ku është.Ai me gjithë famën dhe

autoritetin e tij për të kërkuar mjeshtë. Mirëpo kur ta takon dhe i thot për t'ia rregullu gypat e kanalizimit ,por mjeshtri ia kthenë:Nuk kam kohë se jam i nxënur,ai menjëherë mundohet ta mashtrroj me të holla.Pra këtu njeriu me famë ka ra në pikën ku nuk mund ta rregulloj e shkon te ai i cili ia rregullon.Për këtë arsye Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë:Ne kemi ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin në shërbime.Nuk duhet ta marrim sipërfaqësisht këtë qështje ashtu që në mos të mirremi me asgjë.Nuk duhet ta kuptojmë se çdo njeri është i ngritur ndaj tjetrit vetëm për shkak të pasurisë.Jo!por çdo individ në shoqri është i përlur edhe i lartësuar .Individi në shoqëri është i përlur me atë aftësi dhe mjeshtri të cilën e disponon ,por secili prej neve është i çmuar për diçka tërë jetën.I çmuari e konsideron jo të çmuar në profesionin dhe veprimtarinë e tij,por çdo individ,pra a nuk do të thotë kjo,,që ta konsideroni njëri-tjetrin të nënçmuar".këtë nuk duhet ta marrim një kategori njerëzish ndaj një kategorie tjetër.

Psh.Dietari ,tërë jetën ia ka kushtuar diturisë ,ai njëzet vite ka shfletu libra për të nxjerr në dritë një ligj prej ligjeve të Allahut e pasi të arrij nivelin e duhur të diturisë,deri sa ai është në rrugë i vjen një kalimtar dhe e pyet për ndonjë qështje e ai i përgjigjet.Pyetësi mendon se ai është përgjegjur kalimthi.aty për aty i ka ardh aftësia për të dhënë përgjigje,mirëpo po ta dinte se ai dietari njëzet vite ka lodhur veten e tij,për të tubuar material për ti dhënë përgjigje asaj qështje ai në qastin e pas njëzet viteve do ta kishte konsideruar veten të nënçmuar para atij i cili posedon vetëm një profesion ,ndërsa njerëzit tjerë posedojnë profesione tjera.Kështu profesionin të cilin e ka dhe të cilin e zotëron mirë dhe ka përvojë,ai është

i ngritur dhe i çmuar me te,ai është nënçmues në shërbim të tjerëve të cilët nuk e kanë këtë dhunti.po ashtu edhe tjerët kanë dhunti tjera të cilat janë të dobishme ,kështu që dhuntitë kompletojnë tërësinë e jetës,me fjalë tjera kompletojnë njëra-tjetrën.Pra ky është mbizotërues në këtë,tjetri mbizotërue në atë .Për këtë arsye edhe Kur'ani e ka theksu precizë:Ne kemi caktuar ndër ta gjendjen dhe mënyrën e jetës në këtë botë;Ne kemi ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët,që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin në shërbime"
ZUHRUF-32

Çka do të thotë:dhe ne kemi ngritur?Disa dinë çka nuk dinë të tjerët e këta nuk dinë çka dinë ata?.Pra çdo njeri është i ngritur për diçka dhe jo i ngritur për diçka.Po të ndodh që në një sektor të shoqërisë është përmbushur numri i profesionalizuesve ,e pas plotësimit të atij vjen edhe një tjetër,pastaj bëhet një analiz për secilin profesionist veq e veq dhe çdo njerit i ipet shkalla e aftësisë ,atëherë shuma e të gjithëve është e barabartë me aftësinë e çdo njeriu,mirëpo dallimi dhe ndryshimi qëndron në përsosmërinë e atij profesioni,kështu shoqëria harmonizohet ,e nuk çrregullohet,kështu bëhet bashkpunimi dhe këmbimi i përvojave të kundërta.

Po tkishim qenë të gjithë njerëz të një profesioni atëherë ata do ta largonin dhe dëbonin njëri-tjetrin ,mirëpo ja unë kam nevojë për ty,ti ke nevojë për mua,që të dy ne kemi nevojë për të tjerët.Pra është bënë ndërlidhshmëria e nevojave ose e ambicieve ,ose pasurive e cila ekziston të njerëzittë cilat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën,sepse pamundësinë dhe paaftësinë e këtij e kompletton mundësia dhe aftësia e tjetrit.Pra,duhet që të ekziston rrotacioni i edukimit sepse njeriu është njësi e rrotacionit në shoqëri.

Kjo nësi (ky individ)patjetër duhet ta ketë veqprinë e tij .Mirëpo dëshira duhet të jet prej meje?Dëshira duhet të pëpruhtet me arritje të përsosmërisë së asaj dhuntie në punë,mirëpo kur puna nuk arrin në përkryerjen e asaj dhuntie atëherë unë nuk e dëshiroj.për këtë arsye kur puna e kryer harmonizohet me dhuntinë atëherë vjen dëshira për atë punë . Pra peshoja kryesore me të cilën duhet të dallohemi dhe të matemi është,,Nuk ka dyshim se me i fisnikruar dhe më i nderuar prej juve te Allahu është më i

devotshmi"E pas kësaj Allahu na kalon neve në qështjen prej vëllazërisë së besimit në vëllazërinë njerëzore.E kjo po ashtu duhet të jet veqori kryesore në edukim dhe arsimim.

URTËSIA E BOTËS TJETËR

Pyetje:Dita e botës tjetër është ditë e llogaritjes për ditën e kësaj bote.,,Dhe kush ka bërë ndonjë të keqe ,qoftë sa një thërmijë do ta shohë atë"

SURETU-ZELZELE8

Këtë po e dimë ,mirëpo a ka urtësi tjetër të cilën ne nuk e dimë për qështjen esenciale të botës tjetër?Shpresojm se Imami me famë do të na përgjigjet për këtë,Zoti e shpërbleftë me të gjitha të mirat.

Përgjigje:Qështja e botës tjetër dhe ditës së gjykimit është qështje e Imanit dhe besimit se ti do ta takosh Allahun dhe do të të merr në pyetje.Besimtarit kur ti vjen ndekja,shpirti i tij është i qetë dhe i bindur .Parashtrohet pyetja :Pse?për arsye se ai e di se do ta takon Allahun dhe do të jep përgjigje para Tij.ndërsa pabesimtarit kur të jet para vdekjes i tronditet shpirti,e zemra e tij i mbushet me frikë dhe trishtim.Parashtrohet pyetja :Pse?Se ai në brendi ,në vetëvete e di se do ta takon Allahun,mirëpo dëshiron ta fsheh realitetin të cilin do t'ia zbuloj vdekja.Po mos t'kishte qenë Allahu i Lartëmadhëruar sundimtar i ditës së gjykimit atëherë njeriu i drejtë nuk kishte mund as të lëvizë në këtë jetë.Pse?Sepse nëse aktiviteti yt t'iu kishte përmbajt programit do ti kishte sjellë dobi tjetrit i cili nuk i përmbahet atij programi e ti nuk do t'kishe pas dobi në botën tjetër,pra ti ke gabu sepse tjetri e ka kundërshtu Allahun,dhe ia ka kthyer shpinën Allahut.Po mos t'kishte qenë Allahu i Lartëmadhëruar sundimtarë i ditës së gjykimit atëherë kjo botë do t'kishte qenë botë ku të fuqishmit i shkelin të dobëtit ,dhe të padrejtët do të mmbizotronin ndaj të drejtëve.Mirëpo Zoti i Lartëmadhëruar të qetëson kur thotë:,,Unë jam sundimtar absolut i ditës së gjykimit,qetësohu e mos u brengos.Kjo është arsyeja dhe urtësia pse është dita e botës tjetër e cila është qështje esenciale e drejtësisë së kësaj bote.Ajo është dita e të sqaruarit të drejtës ndaj të padrejtës,në mes të besimtarit dhe pabesimtarit,në mes të mirit dhe të keqit,në mes të fjalës së drejtë dhe të vërtet dhe fjalës së padrejtë dhe gënjeshtres.Dita në të cilën Allahu askujt nuk i bën padrejtësi.Lusim Allahun që atë ditë ta bëjë të dobishme dhe të bekuar për ne ,dhe ditë të mirë të përfundimit të punëve tona ,dhe ditë të mirë të takimit tonë me Te.Aminë

PËRKUJTONI TË MIRAT E TË VDEKURVE TUAJ

Çka do të thotë ,,Përkujtoni të mirat e të vdekurve tuaj?Dhe cila është urtësia gjatë kësaj duaje e melaqet thonë ,,Aminë"

Përgjigje:Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:Qëllimi i lutjes,,Përkujtoni të mirat e të vdekurve tuaj" është që dëgjuesi mos të ndëgjojë se ndonjëri ka vepru keq,e ai ta merr si shembull e edhe vet vepron keq.Por kur t'ia përmendim vetëm të mirat ndonjë personi i cili ka vdek ,atëherë dëgjuesi i merr shembëlltyrë vetëm veprat e mira dhe i vepron ati..Mirëpo kur njeriu dëgjon se i vdekuri ka vepru edhe keq edhe mirë,atëherë ai nuk mund ta paramendij veten e tij me vepru keq,pasi që ai mendon se të gjithë njerëzit bëjnë keq,e nuk është i vetmi ai i cili bënë keq.Mirëpo kur të dëgjon vetëm vepra të mira ,atëherë ne mendjen e tij perqëndrohet ideja se e mira është duke dominu.

Ndërsa sa i përket pjesës ,melaqet thonë,,Aminë" gjatë asaj lutje ,melaqet bëjnë dua për punët e mira.Zoti i Lartëmadhëruar thotë:Ai është i cili ju bën mirë juve(ju bekon) dhe po ashtu edhe melaqet (luten dhe ju bekojnë juve).Kështu melaqet vazhdimisht janë në kontakt

me ne ,e duaja e tyre është që të jemi mirë ne.Për këtë arsye thuhet:Asnjë ditë nuk lind dielli e që dy melaqe mos të jenë pranë,njera të thot:O Zot shtoja pasurin atij që jep ,e tjetra:O Zot zvogloja pasurinë atij që nuk jep.

Pra kur melaqja thot: O Zot shtoja pasurin atij që jep kuptohet se është lutje për te,por si me lut për dorështrënguesin për me iu falë gabimet,kur dihet se melaqet luten vetëm për mirësi?

Nëse shikojm të vërtetën kuptojmë se melaqja kur thotë:O Zot shtoja pasurinë atij që jep,është lutur për mirësi,sepse ai ka vepru mirë.

Ndërsa ai i cili nuk jep melaqja ia siguron dhe ia ruan pasurin e tij sepse është lutur për me iu zvoglu pasuria ,e mos me i ndodh fatkeqësi,e kjo është lutje e mirë për të dhe *themi*:Ju mendoni se ai është lutur keq për te ,e jo mirë për te.Por melaqja është lutur që e mira të shpërblehet me të mirë.Njerëzit patjetër duhet ta shikojnë fundin e rezultatit,e jo vetëm fillimin .E fundi i rezultatit a është në këtë botë a në botën tjetër.

PËRPARSIA E BURRIT NDAJ GRUAS

Pyetje :Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerët dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre. Prandaj, me atë që All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë respektuese, janë besnike ndaj të fshehtës. E ato që u keni dro kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largohuni nga shtrati (e më në fund), edhe rrahni (lahtë, nëse nuk ndikojnë këshillat as largimi), e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. All-llahu është më i larti, më i madhi”.

EN-NISA 3 4

Çka do të thotë:përparësi e burrit ndaj femrës?A mos do të thotë kjo se Allahu e ka vlerësu apo e ka ngrit mashkullin ndaj femrës?

përgjigje:Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Nëse thuhet filani ka marrë përsipër qështjet e filanit ,çka do të thotë:Kjo do të thotë se njeri është ulur e tjetri në këmbë .Kuptimi:përparësi ndaj grave është se ato janë të ngarkuar që të përkujdesen ndaj tyre,dhe angazhohen që të jenë në shërbim të tyre,për çdo qështje,pra përparësi do të thotë detyrë dhe obligueshmëri e burrit.

Ndërsa pjesa e ajetit:Me atë çka Allahu ka dallu disa prej disave.Nuk është ashtu siq mendojnë disa se Allahu i ka dallu meshkujt ndaj femrave.Se po të kishte dashur Allahu ashtu do t'kishte thënë:„Me atë çka Allahu i ka dallu burrat prej grave".Por ka thënë:„Me atë çka Allahu i ka dallu disa prej disave".Që do të thotë e ka përdor termin „disa prej disave" pra të papërcaktuar.Pra kuptimi i ajetit është se „përparësia"është qështje e cila obligon angazhim dhe mund më të madh në anën e burrit për të siguru pasuri përball asaj se ajo(femra) ka vlerë dhe dallohet në anën tjetër ,e ajo është se femra ka rol të cilin mashkulli nuk mund ta ketë ,pra ajo është dalluar prej tij se mashkulli nuk jet shtatëzënë,nuk lind,nuk ka menstruacion.Për këtë arsye në ajet Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë:Dhe mos lakmoni atë që Allahu e ka dallu me diçka ndaj tjetrit.

Kujt iu është drejtuar më këtë fjali?Iu është drejtu të gjithëve.Edhe në këtë pjesë të ajetit Zoti i Lartëmadhëruar ka tregu vlefshmërin e disave ndaj disave ,që do të thotë se disa janë më të dalluar se të tjerët.Nuk mund të bëhet krahasimi në mes të dy personave të cilët kanë role dhe veprimtari të ndryshme ,por krahasimi bëhet në mes roleve dhe veprimtarive,e nëse bëhet ai krahasim atëherë shohim se ato dy janë të kompletuar si tërësi e përbashkët.Mashkulli ka përparësi në angazhim dhe mundim,ndërsa simpatia dhembshuria mungojn te ai për arsye se ai është i preokupuar me qështjet e tij.për këtë

arsye Zoti i Lartëmadhëruar e ka rezervuar femrën që ta kryej rolin dhe detyrën e saj. Nuk e ka ngarkuar me obligim për t'ia marr kohën në punë të rëndë të cilat mund ti kryej tjetri në vend të saj.

Ligjëvënësi na ka vërtetë neve se si mashkulli duhet t'i ndihmojë femrës. Pejgamberi s.a.v.s. kur ka hy në shtëpi dhe ka pa familjen se është angazhu më diçka i ka ndihmu, gjë që tregon se roli dhe detyra e gruas është rol i rëndësishëm dhe që burri duhet t'i ndihmoj asaj.

Femra bashkëpunon dhe vepron me llojin më të përsosur, pra me njeriun, sepse ajo edukon njeriun i cili është udhëheqës në ekzistencë, ndërsa vepron me sendet e ngurta, me dheun, me bimët, me gurët e me shtazët.

TRASHIGIMIA PARA VDEKJES

Një grua para vdekjes ka lënë testament me trashëgu një e afërt e saj tërë pasurin e saj. Një gjë e tillë lejohet me shariatën Islam?

Përgjigje: Shejh Shaëraviu thotë: Më se shumti *përfitohen* atëherë kur lënë vasijet të ndonjëri prej të afërmëve (trashigimtarë) i cili vendim ua merr të drejtën legjitime, e kjo është gjë e urrejtur. Sepse nuk lejohet me iu ndalu e drejta e trashigimisë një njeriu të cilit ia ka leju Allahu të drejtën e tij. Përderisa Allahu ia ka leju ai është i afërti nga të tjerët. E nuk lejohet me lënë vasijet (testament) më shumë se një të tretën e pasurisë së tij. ndërsa dy të tretat janë e drejtë e Allahut, dhe duhet me vepru ashtu si ka dëshiruar ai dhe si i ka parapa Ai normat e trashigimisë.

Zoti i lartëmadhëruar thotë: Baballarët tuaj dhe fëmijët tuaj asnjëri prej juve nuk mund ta dijë se cili prej tyre është më i afërt dhe më i dobishëm. Obligim prej Allahut.

Pasurinë time nuk ia lë atij që e dua, por atij që Allahu ka dashur me ia dhënë. Përderisa njeriu kur ka ardhë në këtë botë dhe nuk ka pasur asgjë me vete, ashtu Allahu e merr, pa i lënë asgjë me vete, e ai nuk ka të drejtë në pasurinë e tij më shumë se në një të tretën, ndërsa pjesën tjetër ia len atyre të cilëve u takon.

Po ashtu duhet që një e treta të jet testament për jotrashigimtarët, nëse i lihet testament trashigimtarit në atë pjesë patjetër duhet të pajtohen që të gjithë trashigimtarët

ZHGJEDHJA E BASHKËSHORTES

Në kohën e sotit, pra në kohën bashkëkohore i riu ballafaqohet me vështërsi në shumë qështje, e prej tyre është martesë me vajzë të pasura, me qëllim që të përfitoj jetë luksoze. Ai as që brengoset, dhe nuk ia vën veshin karakterit shpirtëror dhe fetarë. Sepse ai shikon vetëm nga këndi i lumturisë në këtë botë. Për këtë arsye veprimet e tilla dështojnë plotësisht. Sepse dita ditës në vend se ditët të shkojnë në favor të jetës së tij, ditët shkojnë në disfavor të jetës së tij. Ky veprim është i gabueshëm në llogaritje dhe është veprim i palogjikshëm dhe veprim i mendjes së pazhvilluar, ato edhe pse arsyetohen për këtë, ato patjetër duhet të shiqojnë në aspektin fetar dhe moral para çdo qështje.

Për këtë Shejh Shaëraviu thotë: Mos e bënë pasurinë peshojë të bashkëshortë. Kjo është këshillë e të rinjëve dhe të djemve të sotit. Kjo është këshillë më e mira dhe më e shtrenjta. Pastaj Shejh Shaëraviu vazhdon duke tregu ajetin e librit fisnik ku Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

DËSHMIA E RREJSHME

Pyetje:Cila është dispozita e dëshmisë së rrejshme në Islam,përderisa ne e dimë se kur ka dëshmi të rrejshme ka njeri dëmtues dhe të dëmtuar,e dëmi mund të arrij edhe te shkalla më e lartë që do të thotë deri te vrasja apo dënimi me vdekje?

Përgjigje:Imami i mirënjohur Mumahed Muteveli Shaëraviju thotë:Dëshmia e rrejshme është prej mëkateve më të mëdha.Kur Muhamedi s.a.v.s. i ka përmend mëkatet e mëdha ,ka përmend edhe dëshminë e rrejshme,ka thënë:pra edhe dëshmia e rrejshme ka vazhdu duke u përsërit sa që sahabët kanë mendu se nuk do të ndalet e kurr nuk kanë thënë :A ka njeri po t'ishite ndalur.

Kjo ka ndodh nga shkakut se dëshmia e rrejshme ngërthen në vete tërë padrejtësinë .Ai i cili i bën shok,rival Allahut,ka dëshmu rrejshëm.Kështu te ai dëshmia e rrejshme ka fillu prej Imanit e kështu me radhë.Për këtë arsye ,kur Zoti i Lartëmadhëruar ka përmend cilësitë e robërve të të gjithëmëshirshmit ka thënë:Ata të cilët nuk dëshmojnë rrejshëm.Asnjë njeri nuk mund të hyjë në adhurim te Allahu përderisa nuk bëhet prej atyre të cilëve nuk dëshmojnë rrejshëm.Prej fatkeqsive të këtij krimi është se jo vetëm që bëhet padrejtësia por e legjitimon dhe ligjëson padrejtësinë.Sepse Gjykatësi merr vendim në bazë të dëshmive ,nëse dëshmitë janë të rrejshme ato gjykatësin e shpiejnë në humbje(për të mos gjyko drejtë)

Kështu në krahasimet e rëndomta mes njerëzve dhe pa shiku aspak qështjen e fesë,shiqojmë çka është ajo që të bën që ti të mendosh ndryshe nga të tjerët,nëse i përkrah tjerët në qështje negative si psh. në dëshminë të rrejshme,ti ia ngrit kokën kundërshtarit me dëshminë e tij dhe ia shkel nderin më këmbët e tua.Dëshmitari i rrejshëm ka qen dasht të jet i indinjuar që nga momenti kur kërkohet një gjë e tillë prej tij.Sepse përcaktimi që ai të dëshmoj rrejshëm,nuk është një detyrë e tij që ai patjetër ta pranoj.ndoshta ai është i kënaqur me ty kur ti pranosh që të dëshmosh rrejshëm,në dobi të tij,për t'ia plotësu ndonjë nevojë mirëpo nëse analizon më thellë do ta kuptosh se ai nuk do të besoj ty asnjëher,edhe nëse e flet të vërtetën,sepse ai të ka sprovuar ,ai i cili e ka vërtetu se ti je tradhëtar dhe jobesnik,edhe nëse ndonjëherë tjetër është në dobi të tij.

ndërsa sa i përket të dëmtuarit në raport me Zotin dietarët për këtë thonë:po ta dinte dëmtuesi se çfarë të mira i sjell të dëmtuarit ,ai nuk do ta dëmtonte sepse ,nëse ti e dëmton një njeri ,ta dish se i ke marrë diçka që Allahu ia ka dhënë ,e me këtë ti nuk je kundër atij personi por kundër atij i cili ia ka dhënë atë të drejtë e atëherë ka fillu armiqësia në mes teje dhe Allahut.

Për këtë arsye nuk ka perde(pengesë) në mes të lutjes së të dëmtuarit(atij të cilit iu është bërë padrejtësi) dhe Allahut.Dëmtuesi nuk ka arritur ta dëmtoj aspak tjetrin me padrejtësinë e tij,por përkundrazi e ka shpërbly,sepse Allahu e ka bërë në anën e tij,me këtë dëmtuesit i ka dhënë të mirë të madhe.Allahu e ka leju që i dëmtuari të thotë në veten e tij,dhe mos ta fshejë padrejtësinë e cila iu është bërë ,nëse ajo padrejtësi e mundon.Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë

EN NISA

Poeti ka thënë: Amkesa patjetër duhet të bëhet për të ithtën

e cila të keqëson,të brengos(hidhërimin) të mundon,ose të lëndon

Ndërsa ai i cili e fsheh tërbimin ,ka shkallë edhe më të lartë .Nëse e bëjmë një vështim të kësaj qështje në Kur'an ,shohim se Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë:

ALI IMRAN

Kjo do të thotë se hidhërimi është në gjoks dhe brendësi të njeriut mirëpo i dëmtuari ,dhe i

hidhëruari ,nëse ka mundësi ta mbaj në vete atë hidhërim,ai ka gradë të lartë,është më i fisnikruar dhe më i ngritur,e pas kësaj vjen shkalla tjetër falja e gabimit,e kjo shkallë është mirësia .Islami mirësinë e ka bërë më të ngritur dhe më shpërblyese.Islami e ka leju që njeriu ta nxjerr prej zemrës së tij hidhërimin,por nëse nuk mundet ajo është qështje vetanake,që ai ta shpalos që të qetësohet,dhe të pushoj zemra e të dëmtuarit.E shkalla e Imanit ngritet me mirësi në atë mënyrë që i dëmtuari ti dhuroj shpërblim dëmtuesit.

MARTESA ME TË AFËRMIT

Pyetje: Një djalosh dëshiron të martohet ,çka është më së miri për të,të martohet në mbrendi të familjes me farefis apo me e dobëishme për të është që të martohet me ndonjë vajzë e cila është sa më e largët.Dhe cila është urtësia e mosmartesës me të afërt.Kërkojm nga Imami i nderuar të na sqaroj .Zoti e shpërbleftë.

Përgjigje:I dërguari i Allahut s.a.v.s na ka këshillu që të largohemi e të mos martohemi me farefis,ku ka thënë,,martohuni me vajza sa më të largëta e mos u dobësoni"Sepse martesë me të afërmet rezulton pasardhës të dobët,ndërsa martesë me të largëtat rezulton me pasardhës të fuqishëm.SHkenctarisht është vërtetu se me biologji kur kan bërë bashkëzimin e bimëve të dy llojeve të ndryshme,ku rezultati i prodhimit ka dalë i shumëfishtë se sa më parë.kjo metodologji quhet „bashkëzimit i të largëtave(të llojeve meshkuj dhe femra) e cila sa më të largëta të jenë qiftet rezultati është më i fuqishëm.Pra shkencarisht është vërtetu se pse Kur'ani ka ndaluar martesën me nënat dhe vajzat ,dhe ndalesat tjera,pra për të kriju pasardhës të fuqishëm.Se njeriu sa më shumë që të largohet në martesë prej farefisit pasardhësi do të jet më i fuqishëm.Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:„Martohuni me të largëtat e mos u dobësoni,pra mos lejoni që të krijoni pasardhës të dobët.Për këtë është përhapur poezia e poetit ku thotë

Këshilloj Larpamësit
që të mos martohen me fëmijët e axhallarëve

Po ashtu

Sepse nuk mund të shpëtoj nga të metat dhe dobësia .Po ashtu përshkruajm të fuqishmin dhe guximtarin.Kështu :Djalosh trim të cilin nuk e ka lind valja e axhës,farefis.Sepse do t'kishte qenë i dobët ,sepse dobësimi e sjellë martesë me të afërmit.Përderisa Kur'ani dhe suneti na orientojn dhe na sqarojn këtë,është vertejtë se qështja e parë në edukimin e fëmijës është që ai të ketë dhunti prej Allahut ,të ket veqori dhe specifika të veqanta,që do të thotë t'i ketë të përmbledhura të gjitha cilësitë e një lloji ,e jo të jet i vetmum,vetëm i një fisi,në lloj si ai i cili martohet me të afërmen.Mirëpo kur ai martohet me të largëtën ai veë i ka marrë dhe përfitu cilësitë e fuqishme nga aty,dhe cilësitë e fuqishme nga atje dhe kështu rezulton fëmijë i fuqishëm

SHPJEGIM I SURETU JUSUF

I nderuari Shejh:Në suretu Jusuf ka ndodh konflikt mes vëllezërve të Jusufit dhe Jusufit,konflikt i cili ka shpër deri te marrveshja e tyre për ta lajkatur Jusufin.Si me ndodh kjo kur babai i tyre ka qenë pejgamber.Dëshirojm të na sqaroni çfar e keqe ka ndërhy në shpirtat e vëllezërve të Jusufit.Si ta quajmë ata?

Përgjigje:Disa analiza i ka paraqit Kur'ani në paraqitjen e tregimit në suretu Jusuf,,Jusufi dhe vëllau i tij ,po jan më të dashur të baba i ynë se sa te ne,ndërsa ne jemi grup i fuqishëm"Pra dashuria në një person ndikon që te tjerët të rezulton nyja e të metës.Kjo nyje ndikon pastaj që ai njeri të paraqitet i palogjikshëm dhe joparimor,e jo njerëzor.Për

këtë arsye ,kur e kan ndie vëllezërit e Jusufit,se Jusufi dhe vëllau i tij jan më të dashurit te baba i tyre ,kan fillu me mendu të çlirohen nga ajo dashuri sipas mënyrës së tyre duke thënë,,ne jemi grup i fuqishëm" Ata sikur pak të kishin kuptuar ,do ta kishin ditur të bënë një dallim në mes të dashurisë ,dhe fuqisë së tyre,sepse ai(Jusufi)ka qenë i vogël,e ju mos vendosni e mos krahasoni simpatin dhe dashurinë ndaj tij më simpatinë dhe dashurinë ndaj juve sepse ju e keni kalu fazën e cila bënë dobi dhembshuria dhe dashuria.Çdo njeri prej neve i donë më të vegjëlit.Pse?Sepse ai më moshën e tij në krahasim me vëllezërit tjerë është më i vogli,e ai për shkak të paftësisë së tij ka nevojë për më shumë dashuri.Sikur të vëllezërit e mëdhenjë ta kuptonin këtë raport ,nuk do ta kishin akuzu babën e tyre,dhe nuk do ta kishin marrë si shkak për ta urrejtur vëllaun e tyre të vogël.Jusufi dhe vëllau i tij po jan më të dashur të vëllau ynë,ndërsa ne jemi grup i fuqishëm"Pra ju kami thën ,,ju jeni grup " që do të thotë shoqëri e fortë dhe fuqishme ,e pra nuk paskemi nevojë për ledhatim e dhembshuri dhe për atë dashuri.Pas kësaj çka ka ndodhë?Ndodhi ajo çka ka ndodhë.Kan thënë,,Vriteni Jusufin".Mirëpo pos kësaj është paraqit ndjenja shpirtërore,na paraqitet elementi i të mirës kur të mendohet e keqja,dhe elementi i të keqes kur të mendohet për të mirë.Ata djem ,të pejgamberit.Është e vërtetë se jan të reflektuar prej ndjenjave njerëzore,kan fillu për ta dëmtu Jusufin.Mirëpo shiqoni,planifikimi i dëmtimit ka arrit në shkallën e maksimumit apo të minimumit.Pasi është reflektu dukuria e dashurisë së prindit te Jusufi më e madhe se te ata,ka fillu propozimi i parë,i cili ka qenë propozim,,Hudheni në fund të ndonjë pusi,e pastaj do ta merr atë ndonjë karvan udhëtarësh".Pra të menduarit menjëherë ka reflektu kur kan thënë,,ose të hudhet në ndonjë vend (qytet)tjetër .Pra ata kan lëshu pe prej ides së mbytjes,,që dashuria e babait të kthehet te ju".Pas kësaj pra faza e ekzekutimit dhe pas arsyetimeve ka ardh faza e ekzekutimit,,Hudheni në fund të ndonjë pusi e pastaj do ta merr ndonjë karvan udhëtarësh"

Kjo tregon se nëse mendohet e mira kur kihet për qëllim e keqja,e keqja nuk ngritet shumë por zbrit poshtë.Pasi që e kan mendu për ta mbytur,kan mendu për ta dërgu në një vend të largët,e pastaj kan mendu për ta hudhë në një pusë që ta merr ndonjë karvan njerëzish.pra është zbutë qështja.Për këtë arsye kur dikush thotë:Vëllezërit e Jusufit kanë qenë kështu,e kështu,kan mendu për të keqen kriminale.ne u kundërpërgjigjemi.Kan mendu keq,pse i ka përfshi pluhuri i të keqes por pastaj te ta është reflektu arsyeja.Shiqoni a ka arrit ajo shkallë e të keqes në vepër kriminale të mbytjes apo kan zbrit në minimumin e dëmtimit.Kjo natyrshmëri tregon se kan pasur mirësi në zemrat e tyre.Ajo çka tregon këtë është se nyeja e cila lidhet të njeriu ,çfardo qoft ajo nyje ka reflektim të veçant në ndjenja,përqëndrohet në zemër e mbizotron atë dhe e kontrollom atë,e pastaj sjelljet nuk mund të kontrollohen,pasi që mendja e tij është e mpirë(dehur).shiqoni,pasi që Jusufi është bë ministër i ekonomisë,bujqësisë dhe financave kan shku vëllezërit të ai.e Jusufi për ta ndal për vete vëllaun e tij i ve në grackë,çka kan thënë ato,,nëse ka vjedh,edhe më parë poashtu vëllau i tij ka vjedh".Ende ka vazhdu esenca pra reflektimi i mbrendshëm.Për këtë arsye kur islami parashtron rrugën e edukimit mes fëmijëve e paraqet barazimin mes tyre ose në mes të nxënësve,ose në mes të edukimit të një grup njerëzish.Po,mundet me qen që disa të duhen e disa tjerë mos të duhen,mirëpo në qështjen e edukimit duhet të jen të barabart.Mirëpo këtë lloj të edukimit e quajm që dikush ka dhunti të veçant nga Lartë,dhe ne i marrim të paftit dhe i ngritim në nivelin e atyre të cilëve iu është dhënë dhunti e veçantë.për këtë arsye nxënësat dallohen nga njëri tjetri.**ALLAHU E DI MË SË MIRI**

E DREJTA E FOIUT NË ISLAM

Cilat jan të drejta e fëiut në Islam?

I kan trefu të dërguarit të Allahut s.a.v.s. për një gru e cila agjëron vazhdimisht,jep sadak,mirëpo i ofendon fqinjët e saj,e Muhamedi s.a.v.s. ka thën:Ajo është në zjarr.-Pastaj i kan tregu se filanja pak falet,pak agjëron,pak jep sadak mirëpo nuk i ofendon fqinjët e saj.E Muhamedi s.a.v.s. ka thën :Ajo është ne xhenet. TRANSMETON AHMEDI
Ajsha r.a. ka thënë: Muhamedi s.a.v.s :I kam dy fqinj afër cilit ti jap më parë dhratë.
Muhamedi s.a.v.s ka thën: Cili prej tyre është me derë më afër derës tënde.
TRANSMETON BUHARIU

PLANPROGRAMI EDUKATIV NË ISLAM

Pyetje:Cila është metodologjia më e mira për ti eduku njerëzit në edukatë Islame?

Përgjigje:Ta analizojmë hadithin e të dërguarit të Allahut s.a.v.s. ku thohë:„Çka është në atë tuajin i cili e bënë këtë e këtë".Shohim se ai nuk akuzon vepruesin për atë vepër ,për mos me qitë prej taktit, e kur nuk e qet prej taktit,por e turpëron.Këtë e bënë pse dëshiron që atë ta nderoj si pjesë të shoqërisë.Mjafton që njeriu vet me ditë se ka të metë,e të tjerët mos me ditë se ai ka atë të metë.Pas kësaj i dërguari i Allahut s.a.v.s tregon rrugën bazore në edukim,e ajo rrugë është edukuesi të pason rrugën që të edukuarin ta sjell te edukimi nëpërmjet rrugës sa më të shkurtër,për çfarëdo qështje prej qështjeveDisa qështje vështirë është me i vulosë me mendje të tjerëve,mirëpo edukuesi duhet me pas pregaditje profesionale,dhe t'i vendos të gjitha mjetet në disponim për me ndiku të i edukuari,te e vërteta të cilën e dëshiron në mënyrën më të lehtë dhe rrugën më të shkurtër.

Imam Ahmedi dhe *Bajhekiu* në librin e tij,„Degët e Imanit kan regjistru hadithin nga Ebi Umamete r.a. se një djalosh ka shku te peygamberi s.a.v.s dhe i ka thënë:O i dërguari i Allahut,më lejo që ti dashuroj gratë.Disa njerëz deshën ta dëbonin ,por Muhamedi s.a.v.s tha:Silleni ,silleni më afër.Pastaj i tha ulu, dhe ai është ulur,e peygamberi s.a.v.s e pyet: A dëshiron që të tjerët ta dashurojn nënën tënde.Ai thotë:Jo për Zotin,po unë do të sakrifikohesha për të.Po ashtu edhe tjerët i duan nënat e veta(që mos ti dashuroj askush).Pastaj peygamberi s.a.v.s e pyet:Po a dëshiron që vajza jote të jet ashtu.Jo për Zotin ,po unë do të sakrifikohesha për te.Po ashtu edhe tjerët i duan vajzat e tyre(mos ti dashuron askush).Pastaj i dërguari i Allahut s.a.v.s e pyet:Po a dëshiron që motra jote të jet ashtu.Jo për Zotin,po unë do të sakrifikohesha për te.Po ashtu edhe të tjerët i duan motrat e tyre(që mos ti dashuroj askush).Pastaj i dërguari i Allahut .s.a.v.s. e pyet:Po a dëshiron që halla jote të jet ashtu.Jo për Zotin,po unë do të sakrifikohesha për te.Po ashtu edhe të tjerët i duan hallat e tyre(që mos ti dashurojaskush)Pastaj i drëguari i Allahut .s.a.v.s e pyet:Po a dëshiron që tezja jote të jet ashtu.Jo për otin ,po unë do të sakrifikohesha për te.Po ashtu edhe të tjerët i duan tezët e tyre(të mos i dashuroj askush)Pastaj i dërguari i Allahut s.a.v.s. e vendos dorën në krahërorin e tij dhe thot:O Zot falja gabimet,pastroja zemrën,dhe bëne të moralshëm.Pas këtij rasti ai djalosh nuk ka shiku diçka tjetër dhe ka thënë:Për Zotin çdo her kur epshi im anonte të bëjë një mëkat të atij lloji,më kujtohej sikurse do ta bëj më nënën time ,me vajzën time dhe për atë jam larguar.

Pra i dërguari i Allahut s.a.v.s ka sjell qështjen aq afër që me pa ai fisnikrinë e tij,ndjenjat e tij,vendin e tij e pozitën e tij.E kur të dëshiroj me bë një gjë të tillë ta kujtoj se çka është me vepru

Kjo është metodologjia më e mirë për të arritur fisnikrinë të cilën na e ka mësu i dërguari i ALLahut s.a.v.s se si me këshillu më së miri,dhe si ndikon te të tjerët kur të depërtoj e vërteta në zemrën dhe natyrshmërinë e njeriut.Po pra.Këshille e mirë dhe logjikë e shëndoshë

ASKUSH NUK E BARTË BARRËN E TJETRIT

Kemi ajetin Kur'anor,„Dhe askush nuk e bart barrën e tjetrit"Po ashtu edhe ajetin tjetër:„Për t'u ngarkuar me barrat e tyre në ditën e kjetimit,dhe me barrat e atyre të cilët i kan devijuar pa kurrfarë diturie"

I nderuari ynë:A nuk jan në kundërshtim mes veti këto dy ajete.Ju lutemi të na sqaroni.Zoti ju shpërbleftë

Përgjigje:Kuptimi i ajetit,„Dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit" është drejtësi e Allahut.është të mos e dënoj të pafajshmin(jomëkatarin) për mëkatin e tjetrit,pra nuk ka dënim në ndërmjetësim.Mirëpo pastaj vjen ajeti tjetër Kur'anor ku thotë:„Për t'iu ngarkuar me barrat e tyre në ditën e kjetimit dhe barrat e atyre të cilët kanë devijuar pa kurrfarë diturie".Për këtë ajet themi:Nuk është në kundërshtim me ajetin e parë ,sepse „Ata jan ngarkuar me barrën e atyre të cilën barrë e kan kriju duke i humbur,apo deviju të tjerët,pra me barrën e devijimit të të tjerëve.Pra barra e parë barra e vetdevijimit,ndërsa barra e dytë ,barra e devijimit të tjetrit.

TRADITA DHE IBADETI

Çfarë faji ka ai i cili jeton në një vend ku shoqëria është e keqe,dhe çka është puna me atë i cili jeton në një shoqëri të mirë,ku i riu rritet në ambient të përshtatshëm të fesë së prindërve të tij,dhe nuk e devijon askush.

Përgjigje:Shejh Shaëraviu përgjigjet:Për deri sa njeriu bëhet i pavarur dhe i logjikshëm ,ai edhe pyet për çdo gjë dhe kërkon sqarime për çdo gjë.Ai e zgjedh rrobën(pallton) për veten e tij.Dhe shikon çfarë rezultati ka arritur në shkollë të mesme ,për të pasur sukses në fakultet në të cilin dëshiron.

Atëherë ,pse po ekzistoka dëshira vetanake për të zgjedhurqështjet ,e mos të ket dëshirë(drejtë) vetanake për të njohur fenë e tij.Ai i cili merret me një qështje interesohet për te.Argumentimi në atë se shumica e atyre që jetojnë në ato vende e njohin fenë e tyre ,dhe i përmbahen fes së tyre,mirëpo e vërteta është e kundërt se shumica e atyre të cilët rriten në një vend të mirë bëhen të këqinj.Për këtë arsye i dërguari i ALLahut s.a.v.s ka thënë:Zoti e bekoftë njeriun i cili ka ndëgju fjalën time ,pastaj e mban në vete dhe ia përcjell atij që nuk e ka ndëgju apo nuk e di".Kjo është për shkak se ndodh kompletimit të asaj ,të cilën ai e ka mësu pastaj ia përcjell tjetrit që edhe tjetri të përfitoj prej saj.Kjo gjithashtu është mirësi edhe për vet besimtarin,sepse nëse unë e mësoj ,e edukoj një njeri ,kam arritur një të mirë e cila do t'më rikthehet në jetë po nëse e lë të keqen ashtu siq është ,do t'më përfshijë fatkeqësia e asaj të keqe.Është në interesin tim që të ndikoj me mirësin time dhe ajo e mirë pastaj të kaloj te tjetri ,e në dëm timin është e keqja të kajoj te tjetri.

Pra ,në interesin tim është që i dituri t'ia mësoj të mirën tjetrit e ai tjetri të sillet mirë me mua.Kjo është thuaja se jam duke bërë mirësi për vten time.Për këtë arsye i dërguari i ALLahut s..a.v.s. ka thënë :Nuk ka besuar askush prej jush deri sa mos ta dojë për vëllaun e vet atë që e do për vete"Kjo pra kthehet në dashuri të ndërsjelltë njerëzore.nëse unë jam besnik ,e mira e besnikrisë sime do të qarkulloj në rrethin tim,dhe do t'më besojn atë për

çkakan nevojë.Ndalesa në një mes tjetër ,nëse është hajn,e keqja e atij hajni do t'më kaploj mua,kur t'ma vjedh pasurinë time ndërsa e mira shkon *ne te ata*.
pra për të përfituar të mirën e tyre patjetër duhet t;ua përcjell të mirën time atyre.

DITËLINDJA E MUAHMEDIT A.S.

Çka mendon Imami i nderuar në lidhje më manifestimin e ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s me zbulime dhe ëmbëlsira?

Përgjigje:Manifestimi i ditëlindjes së peygamberit ëshë pasimi me ata çka dëshiron i manifestuari.Imami i nderuar pastaj shton:Sa më shumë që manifestojmë këtë ditë ,aq më pak përfitohet prej atij manifestimi.Nëse për çdo manifestim të ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s. bëhet që të gjallërohet një simbol prej simboleve të fesë së tij feja e tij do të përforcohej në çdo vend.Mirëpo siq shihet në vetkënaqemi me pjesën e jashtme të manifestimit,pra me në ato çka na ka ëndja neve me ushqim vjetor,ëmbëlsira ,pamje të bukur ,feja e Allahut është shumë larg prej pamjeje të jashtme.

Nëse shohim zbulimet të cilat bëhen në këtë festë do ta kuptojm se sa njerëzit e duan këtë fe,por nëse hymë nëpër shtëpitë e tyre të cilët bëjnë këto zbulime do ta kuptonim se sa larg jan ato nga feja e tyre.

Është e vërtetë ,ditëlindja e Muhamedit s.a.v.s është ngjarja më e rëndësishme në këtë botë,bile më e rëndësishme se vet kjo botë se Muhamedi s.a.v.s ka sjell programin për për ta harmonizuar tërë këtë gjithësi.ditëlindja e peygamberit s.a.v.s është mostra e mirësisë së tërë ekzistencës .Njeriu nuk duhet t'i bëjë krim vetes.Por bëhet pyetja si i bën njeriu krim vetes?Atëherë kur ka mundësi ti sjell dobi vetës e nuk e bën.Kur i shkëlqeu drita ,e nuk udhëzohet në te.

Për këtë arsye në ditëlindje duhet të koncentrohemi në atë çka e dëshiron manifestuesi i ditëlindjes(dhe atë çka e dëshiron Krijuesi i atij të linduri)

Islami nuk ka nevojë për amballazhë,që do të thot më ia tërhjek vëmendjen tjetrit me pranë vetëm për shkak të amballazhës.ndjenja në esencën e qështjes është origjinaliteti,ndërsa ndjenja në sipërfaqen(amballazhën) e qështjes është origjinaliteti.

Nuk duhet anashkalojmë ditëlindjen e të dërguarit s.a.v.s nga rpogrami i vet tij.le ti përmbledhim ngjarjet e fesë ,të cilat na perkufizojn ne praktikimin f programit fetarë.

FORMA E MBULESËS ISLAME

Pyetje: A ka kushte tjera të cilat duhet plotësuar për të qenë mbulesa islame.

Përgjigje: Po, ka kushte tjera, patjetër duhet plotësuar ato, e ato janë:

- Që vet rroba mos të jetë zbulim, e kjo kuptohet nga fjala e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe mos ti paraqesin stolitë (zbulimin) e tyre.” Dhe fjala e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe qëndroni nëpër shtëpitë e juaja, dhe mos u zdishni me të ndeshurit e kohës së mëparme të injorancës.”

- Që të jetë e trashë, jo tepër e hollë. Ky kusht kuptohet nga thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “Në fazën e fundit të metit tim do të ketë gra të veshura me rroba të tejdukshme dhe kokat e tyre do të jenë të qethura . Mallkoni ato se edhe ashtu janë të mallkuara”.

- Që të mos jetë e ngjitur për trupi sa që të shihet i tërë trupi.

- Që të mos jetë e parfumuar. Ky kusht shihet qartë në thënien e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “Çdo grua e cila parfumohet dhe shkon e kalon nëpër një turmë njerëzish për ta ndierë erën e saj, ajo është (nxitje) prostitutë”.

- Po ashtu gruaja nuk guxon t’i ngjasojë meshkujve. Kjo kuptohet te thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “Nuk është prej nesh gruaja e cila dëshiron t’i ngjasojë mashkullit e as mashkulli i cili dëshiron t’i ngjasojë femrave.”

- Gjithashtu që rroba të mos i përngjet rrobave të pabesimtarëve, sepse në shumë ajete kërkohet që muslimanët të mos i pasojnë epshet e pabesimtarëve.

- Të mos jetë rroba për t’u krekosur dhe lavdëruar. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Kush e vesh në këtë botë rrobën e kryelartësisë, Allahu do ta veshë me rrobën e nënçmimit në Ditën e Kijametit e pastaj e hedh me atë rrobë në zjarr.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka folur të vërtetën.

MBULESA ISLAME

Janë paraqitur pyetje të shumta nga shumë vende rreth formës së mbulesës së femrës në Islam.

Sa i përket formës së mbulesës së femrës në Islam Shejh Shaëraviju thotë se Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, babajve të vet ose babave të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”

(En-Nur, 30-31)

Shami do të thotë mbulim i kokës dhe ballit , pjesës së qafës dhe gjoksit. Kërkohet që të mbulohet koka, qafa dhe gjoksi. Si bëhet kjo? Kjo është mbulimi i pjesës së epërme. Po cila është pjesa e mbulimit të pjesës së poshtme? Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, babajve të vet ose babave të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”

(En-Nur, 30-31)

Bukuria e këmbëve janë deri te zogjtë e këmbës, pasi që i mbulonin me rroba të ngjyrosura ashtu siç e tregon ajeti fisnik, sepse në atë kohë ato u binin tokës me këmbët e tyre për t’u parë bukuria e këmbëve të tyre prapa tyre.

Kur Esmë e Bija e Ebu Bekri Sidikit një herë hyri te Muhamedi s.a.v.s. i thotë Muhamedi s.a.v.s.: “Oj Esmë, femra kur arrin pubertetin prej momentit kur t’i paraqitet menstruacioni nuk lejohet t’i shihet (nga trupi), pos kësaj dhe kësaj, dhe ka sinjalizuar Pejgamberi s.a.v.s. në zogjtë e këmbës së tij dhe fytyrës së tij.

Zonja Aishe tregon: “Gratë e besimtarëve shkonin në xhami dhe e falnin namazin e sabahut me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të mbuluar me mbulesat e tyre dhe ktheheshin në shtëpitë e tyre, pasi e përfundonin namazin dhe nuk i njihte askush.

MË TË SPROVUARIT

Pyetje: A është e vërtetë se njeriu sprovohet varësisht prej fesë së tij? Apo fatkeqësitë dhe sprovat e njëpasnjëshme janë si rezultat i hidhërimit të Zotit ndaj robit të Tij. Dhe këto sprovime a i fshinë mëkatet apo ato janë çështje në vete?

Përgjigje: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. se cilët njerëz sprovohen më së shumti, e ai është përgjigjur: Pejgamberët e pastaj të ngjashmit me ta, e pastaj të ngjashmit me ta. Sprovohet njeriu varësisht prej fesë së tij. Nëse është i dobët në fe, sprovohet aq sa është i dobët; nëse është i fortë në fe, sprovohet aq sa është i fortë. Njeriu vazhdimisht e përcjellin fatkeqësitë derisa të ecë nëpër tokë pa pasur asnjë gabim.”

(Transmeton Ahmedi, e ka vërtetuar Tirmidhiu)

DALLIMI NË MES ANALFABETIT DHE INJORANCËS

Cili është dallimi në mes të fjalës analfabet dhe fjalës injorancë? Me fjalë tjera, çfarë kuptimi ka fjala e parë e çfarë kuptimi ka fjala e dytë?

Përgjigje: Dijetarët mendjelehtë dhe të cekët mendojnë se fjala “injorancë” ka kuptimin e mosditurisë dhe se ajo fjalë e ka të njëjtin kuptim siç e ka fjala “analfabet”. Jo nuk është ashtu! Injorancë ka kuptim në vete, analfabetizëm ka kuptim në vete. Analfabet quhet kur njeriu nuk di diçka. Për atë njeri thuhet “nuk e di”, ashtu siç nuk ka ditur në ditën kur ka lindur prej nënës së tij. Ashtu siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: “Allahu ju ka nxjerr prej

barqeve të nënave t'uaja kur nuk keni ditur asgjë.” Pastaj i ka përmendur mjetet e diturisë: dëgjimin, shikimin dhe mendjen. Pra, analfabet është ai i cili nuk di diçka se prej çfarë është ose nuk e di për një çështje se prej cilës çështje (përbërje) është, ose të mos e dijë një argument prej argumenteve. Mirëpo injoranca nuk është kështu. Injorancë është ta dish një çështje gabimisht, për këtë arsye të shëruarit e injorancës është shumë më e vështirë se të shëruarit e analfabetizmit. Sepse te injoranti në rend të parë duhet çrrënjësuar nga ai atë që e ka mësuar gabimisht, e pastaj përball saj duhet vendosur të pagabuarën, pra të vërtetën.

EMRI I MIRË ËSHTË E DREJTË E FËMIJËS

A është e drejtë e imja që prindi të ma zgjedh emrin e mirë të cilin e mbaj gjatë tërë jetës, të jem krenar para bashkëkohanikëve e që të mos jem mjet i humorit, nëse e kam emrin e keq i cili nuk më ndahet as kur jam i vetmuar, as kur jam me shokë, as në gjumë e as zgjuar, sa që emri bëhet barrë e rënd gjatë tërë jetës e deri në vdekje, të cilin nuk e dua. Ky është një problem i cili më mundon. A mund të marr përgjigje të kënaqshme, shpresoj në këtë, Zoti ju bekoftë.

Përgjigje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Emërtohuni me emra të bukur, sepse ju në Ditën e Kijametit do të thirreni me emra t'uaj.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. këtë e ka praktikuar edhe në jetë, sa që edhe vendi i cili nuk ka pasur kuptim të mirë nuk ka ndaluar andej. Ishte duke kaluar nëpër një rrugë, e cila ishte në mes të dy kodrave. Ka pyetur për emrat e kodrave dhe i tregojnë. Kjo kodër quhet “Pikëllim”, kjo tjetra “Kodra e Turpit”, ndërsa Muhamedi s.a.v.s. nuk ka kaluar në mes të atyre dy kodrave. Ai dëshironte ta mjelë një dele dhe i thërret shokët që ta mjelin, dhe i thotë: “Kush dëshiron ta mjelë?” Një njeri tha: “Unë.” Pejgamberi s.a.v.s. e pyet: “Si e ke emrin?” I thotë: “Ithësirë”. Këtij i thotë: “Ulu”. Pastaj lajmërohet tjetri dhe i thotë: “Si e ke emrin?” Ai i thotë: “Hurb – Sulmues”. I thotë: “Emrin e kam Jeton”. I thotë: “Ti mile”.

Nga kjo tregohet se e drejtë e fëmijës është që baba t'i zgjedhë emër të mirë.